Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes në mediat dhe komunikimin publik (analiza)



İM@

PUBLIKIM ELEKTRONIK:

DISKRIMINIMI DHE GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK

(ANALIZA)

Publikim elektronik: "Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes në mediat dhe komunikimin publik (analiza)"

Botues:

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

Redaktor:

Petrit Saraçini, kryetar i IMA

Autorë:

Biljana Georgievska

Sllavica Anastasovska

m-r Manja Veliçkovska

m-r Gracija Atanasovska

m-r Sara Milenkovska

Përkthimi:

Riza Imeri

Dizajni:

Jane Stefanov

Shkup, dhjetor 2024

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).

PËRMBAJTJA

HYRJE 5

BILJANA GEORGIEVSKA
DITA KUR MEDIAT SHKELËN KODIN DHE TË DREJTAT E NJERIUT 7

SLLAVICA ANASTASOVSKA
RRJETET SOCIALE, PORTALET E INTERNETIT DHE GJUHA E URREJTJES 17

m-r MANJA VELIÇKOVSKA, m-r GRACIJA ATANASOVSKA, m-r SARA MILENKOVSKA
CENSURA, BOJKOTIMI DHE KUFIZIMI I HAPËSIRËS PËR VEPRIM TË AKTIVISTËVE TË LGBTQI+ DHE ARTISTËVE SI REZULTAT I GJUHËS SË URREJTJES 27

Hyrje

Publikimi “Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes në mediat dhe komunikimin publik (analiza)” sjell analiza autoriale nga Biljana Georgievska – gazetare dhe drejtoreshë ekzekutive e Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni, Sllavica Anastasovska – Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe m-r Manja Veliçkovska, m-r Gracija Atanasovska dhe m-r Sara Milenkovska – hulumtuese nga Koalicioni MARGJINAT. Autoret kanë përvojë shumëvjeçare në media dhe në zbatimin e hulumtimeve në organizata që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

Përmes analizimit të shembujve dhe rasteve studimore nga përmbajtjet mediatike dhe rrjetet sociale, analizat autoriale në këtë publikim i detektojnë format dhe narrativat kryesore të shkeljeve të të drejtave të njeriut, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media dhe rrjetet sociale, me fokus mbi grupet shoqërore dhe individët që janë më së shpeshti në shënjestër të përmbajtjeve të tilla, të cilat shpesh përmbajnë dezinformata, gjuhë diskriminuese, gjuhë të urrejtjes, por edhe thirrje për dhunë. Analizat sjellin edhe konkluzione dhe rekomandime për zgjidhje të mundshme, të cilat do të kontribuonin për ballafaqim më të mirë me këto shkelje në komunikimin mediatik dhe publik.

Publikimi është pjesë e aktiviteteve të Institutit për Media dhe Analitikë IMA, të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli, dhe është një kontribut në realizimin e angazhimeve të IMA-s për avancimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, përmes bashkëpunimit me institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat për përballje me dëmet nga polarizimi, gjuha e urrejtjes, dezinformatat dhe sulmet ndaj mendimtarëve kritikë në media dhe në komunikimin publik.

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

1. DITA KUR MEDIAT SHKELËN KODIN DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Shkruan: BILJANA GEORGIEVSKA

Pranë trupit të njeriut të vrarë, në qendër të Shkupit, menjëherë pas sulmit që ndodhi në fund të gushtit, veçmë po mblidheshin familjarët e tij. Të tronditur, ata mbanin njëri-tjetrin, mbështetnin njëri-tjetrin, të mposhtur nga stresi dhe fatkeqësia e papritur... Një ose dy orë më parë, mediat kishin filluar të botojnë informacione për vrasjen, duke bërë gara mes tyre me spekulime - për identitetin, profesionin dhe motivet e mundshme për vrasjen e njeriut.

Ndonjë nga të afërmit, të mbledhur në vendin e incidentit, ndoshta tashmë i kishte parë fotografitë e publikuara ku shihet trupi i mbuluar i pajetë, por me siguri nuk vërejtën se disa nga mediat po bëjnë video nga momentet e tyre të zisë dhe po i transmetojnë në faqet e tyre të internetit. Këto incizime, të publikuara në faqen e një televizioni të Shkupit, paraqesin shkelje jo vetëm të Kodit të Gazetarëve, por edhe të të drejtave themelore të familjes, mbi të gjitha të së drejtës së tyre për privatësi në momentet e dhembjes dhe pikëllimit (neni 7 i Kodit të Gazetarëve: Gazetari do ta respektojë privatësinë e personit, përveç kur kjo bie ndesh me interesin publik. Gazetari është i detyruar ta respektojë dhimbjen dhe vuajtjen e personit. Neni 8: Mënyra e informimit në raste të fatkeqësive, tragjedive familjare...duhet të jenë e çliruar nga sensacionalizmi).

Me tituj identikë në dhjetëra media që përmbanin edhe spekulime identike, atë paradite u cenua dukshëm edhe e drejta e lexuesve të tjerë - për informim të saktë dhe në kohë, e garantuar në nenin 16 të Kushtetutës së vendit. Kështu, fillimisht u shqetësuan njerëzit e afërt të "avokatëve të famshëm të Shkupit", sepse titujt spekulativë pretendonin se "Në të shtënat në afërsi të QT Mavrovasja u vra një avokat i famshëm nga Shkupi...", pastaj u shqetësuan njerëzit e afërt të meshkujve që punojnë në tregti të argjendarisë, pasi disa media, në kërkim të detajeve të reja për rastin, raportuan se "I vrari ishte argjendar, e jo avokat...", madje edhe se "nipi i një argjendari është vrarë para qendrës tregtare Mavrovasja...".

Gjatë kësaj, shumica e mediave e ilustruan tekstin me fotografi që tregon trupin e mbuluar ose të mjegulluar të një burri të shtrirë në një parking pranë disa automjeteve. Por, një nga portalet vendosi të shkojë më tej në garën për klikime dhe publikoi një fotografi tejet shqetësuese ku duket qartë, pa asnjë mjegullim, trupi i pajetë i të vrarit, i veshur me pantallona ngjyrë të çelur dhe një bluzë të errët, gjë që sigurisht shkaktoi ethe te të gjithë ata që atë mëngjes kishin ndonjë burrë të afërt të veshur me tone të ngjashme.

Çdo vrasje është lajm shqetësues, por kur shkelen rregullat për raportim të përgjegjshëm, profesional dhe etik, lajmi bëhet shkelje jo vetëm e të drejtave të njeriut të familjes së ngushtë, por edhe e ndjenjave të publikut të gjerë, gjë që rezulton në një rënie të justifikuar të besimit në media dhe dyshim në cilësinë e profesionit të gazetarisë.

Menjëherë pas këtij rasti, në Këshillin për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM), konkretisht deri te Komisioni i Ankesave, arriti një ankesë[1] nga një familjare e burrit të

vrarë në afërsi të QT Mavrovasja. Në të thuhet se me videon e transmetuar në faqen e Facebook-ut të TV 21, me titullin "Vrasja në afërsi të Q.T. "Mavrovasja", familjarët arrijnë në vendin e Ngjarjes», është cenuar privatësia dhe është bërë paraqitje e pambrojtur e një të mituri, gjegjësisht djalit të saj, në vendin e vrasjes. Gjithashtu, në ankesë thuhet se në video shfaqet familja në zi, menjëherë pas vrasjes së anëtarit të familjes, pa respektuar privatësinë e tyre.

Sipas procedurës së trajtimit të ankesave të parashtruara, Zyra Ekzekutive e KEMM kontaktoi me median, duke informuar njërin nga redaktorët e treguar në impressum për pretendimet në ankesë, duke ofruar edhe mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim – gjegjësisht me një kompromis ndërmjet dy palëve, siç parashikohet në Rregulloren e Punës së Komisionit të Ankesave të KEMM. Personi përgjegjës i medias u pajtua menjëherë për që videoja e kontestuar të hiqet nga faqja e televizionit në Facebook, gjë që ishte e pranueshme për ankuesen, e cila reagoi me fjalët: Për ne është e rëndësishme që kjo të hiqet dhe asgjë tjetër!

Anëtarët e Komisionit për Ankesa, pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve, përfshirë komunikimin me ankuesin dhe median, vlerësuan se janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e rastit me ndërmjetësim. Në arsyetimin e tij, Komisioni shtoi se ankuesi me të drejtë i referohet raportimit joetik që përmban baza për cenim të privatësisë dhe shkelje të të drejtave të të miturve:

"Media ka përgjegjësi dhe duhet t'i kushtojë vëmendje përmbajtjes, por edhe komenteve. Komisioni u bën thirrje mediave që të jenë veçanërisht të kujdesshme kur në punën e tyre të përditshme raportojnë për ngjarje të ndjeshme nga këndvështrimi i respektimit të privatësisë, dhembjes personale dhe të miturve. Këto çështje rregullohen me Kodin e Gazetarëve dhe Udhëzimet për raportimin etik në mediat online. Komisioni rikujton në veçanti nenet 7.1 dhe 8.2 të Udhëzimeve:

7.1 Temat që lidhen me tragjeditë personale do të trajtohen gjithmonë me kujdes, ndërkaq personave të prekur nga tragjedia duhet t'iu qaseni me kujdes dhe diskrecion. Asnjë emër ose fotografi e viktimave nuk do të publikohet kur raportohet për aksidente, vepra penale, vetëvrasje ose dhunë në familje. Nuk do të publikohen as të dhëna nga të cilat në mënyrë indirekte do të mund të zbulohet identiteti i viktimës ose i autorit të krimit, para se të shpallet zyrtarisht nga institucionet kompetente...

8.2. Mediat online do të jenë veçanërisht të kujdesshme kur publikojnë pamje të dhunës, brutalitetit ose vuajtjes, ndërsa prioritet do të jetë mbrojtja e dinjitetit të viktimave dhe atyre që preken në çfarëdo mënyre nga ngjarjet".


Për mënyrën në të cilën raportuan mediat për vrasjen në afërsi të QT Mavrovasja që ndodhi më 20 gusht 2024, në KEMM ka mbërritur vetëm një ankesë. Publikimi i fotografisë së trupit të pajetë pa mjegullim kaloi pa u vënë re nga individët apo institucionet, të cilët kanë njohuri për mekanizmat e vetërregullimit të medias dhe që e zotërojnë procedurën e dërgimit të ankesës në KEMM. Ekipi i medias që publikoi foton shqetësuese e hoqi imazhin pas disa orësh. Por asnjë media e vetme nuk pati guximin të kërkojë ndjesë, as për fotot dhe videot shqetësuese, e as për spekulimet e shumta të futura në raportimin për incidentin si "detaje të reja për vrasjen në QT Mavrovasja".

Shkeljet më të zakonshme të dispozitave etike të të drejtave të njeriut

Kur bëhet fjalë për të drejtat e njeriut, mediat kanë një rol jashtëzakonisht të përgjegjshëm, duke mbrojtur dhe promovuar të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes së të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë, të garantuar nga disa dokumente ndërkombëtare, si: Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut e miratuar më 10 dhjetor 1948 dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokumentet shtetërore (për shembull, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut), vendimet e qeverisë dhe kodet e organizatave të shoqërisë civile.

Duke raportuar për tema të ndryshme, mediat e ngritin vetëdijen e përgjithshme të popullatës për rëndësinë e respektimit të të drejtave të të gjitha komuniteteve, në baza të ndryshme: etnike, racore, gjinore, fetare, politike, seksuale, moshe, shëndetësore... Përmes mediave, mësojmë për llojet e ndryshme të dhunës, por edhe për hapat që duhet të ndërmarrin individët dhe institucionet për ta sanksionuar atë. Është media ajo që tërheq vëmendjen për cenimin e lirive dhe të drejtave të grupeve minoritare apo të margjinalizuara, por edhe ndaj efikasitetit apo mosfunksionimit të reagimit të shoqërisë ndaj këtyre çështjeve. Por, jo rrallë, janë mu mediat, ato tradicionale dhe të ashtuquajturat media të reja apo digjitale, që drejtpërdrejt apo tërthorazi shkelin rregullat e raportimit profesional dhe gazetarisë së përgjegjshme, duke luajtur një rol negativ në raport me të drejtat e njeriut të të gjitha komuniteteve.

Të dhënat statistikore për ankesat e pranuara në KEMM tregojnë se që nga viti 2014, kur organizata filloi të funksionojë si organ i vetëm vetërregullues i mediave në Maqedoni, Komisioni për Ankesa ka pranuar mbi 920 ankesa, prej të cilave ka marrë vendime për pothuajse 800, ndërsa 114 janë refuzuar për shkak se nuk është vërtetuar bazë për fillimin e procedurës. Nga rastet që janë proceduar, vetëm 5% janë zgjidhur me të ashtuquajturën zgjidhje miqësore (amicable solution), pra me ndërmjetësim. Për pothuajse 550 nga ankesat e marra është vërtetuar se janë me bazë, gjegjësisht se mediat kanë shkelur ndonjë dispozitë të Kodit të Gazetarëve. Ndërsa në 165 raste është konstatuar se ankesat e parashtruara kanë qenë të pabaza[2].



Вкупен број на одлуки по години

Neni i shkelur më shpesh i Kodit të Gazetarëve (dhe Udhëzimeve për raportimin etik në mediat online[3]) është neni 1 që i referohet saktësisë së informacionit dhe nevojës që

ai të verifikohet nga sa më shumë burime (neni 1: Gazetari ka të drejtë për qasje të lirë në të gjitha burimet e informimit që janë me interes publik. Gazetari duhet të botojë informata të sakta dhe të provuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale dhe të falsifikojë dokumente. Nëse informata nuk mund të konfirmohet, ose nëse bëhet fjalë për supozim, respektivisht spekulim, kjo gjë duhet të thuhet dhe të publikohet. Saktësia e informatës duhet të provohet sa më shumë të jetë e mundur).

Më pas për nga frekuenca e shkeljeve është neni 13, i cili i referohet detyrimit për të dalluar lajmin nga komenti në përmbajtjen mediatike (neni 13: Gazetarët duhet të bëjnë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit).

Por, pas këtyre shkeljeve më të shpeshta të "rregullave të lojës" në gazetarinë profesionale që kanë të bëjnë me saktësinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit, pa imponuar opinion (lexuesve/shikuesve u ofrohen fakte, nga të cilat mund të nxjerrin përfundimet e tyre), vijojnë shkelje të disa neneve (nenet 7, 8. 9, 10 dhe 11) të Kodit të Gazetarëve – që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut:

7. Gazetari do ta respektojë privatësinë e personit, përveç kur kjo bie ndesh me interesin publik. Gazetari është i detyruar të respektojë dhimbjen dhe pikëllimin personal.


8. Mënyra e informimit në raste të fatkeqësive, katastrofave natyrore, luftërave, tragjedive familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jetë e çliruar nga sensacionalizmi. Në proceset gjyqësore duhet të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë, të raportohet për të gjitha palët e përfshira në kontest dhe të mos sugjerohet vendimi.

9. Gazetari nuk duhet të intervistojë ose të fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve ose kujdestarit, përveç nëse kjo nuk është në përputhje me të drejtat e fëmijëve. E njejta zbatohet edhe për personat me nevoja të posaçme, të cilët nuk janë në gjendje të gjykojnë me vetëdije.

10. Gazetari me vetëdije nuk do të krijojë ose përpunojë informata, që cënojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të përdorë gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë ose diskriminim mbi çfarëdo lloj baze qoftë (kombëtare, fetare, racore, gjinore, shoqërore, gjuhësore, politike, orientimi seksual...)

11. Gazetari do t'u përmbahet standardeve të pranuara shoqërore që kanë të bëjnë me mirësjelljen dhe respektimin e dallimeve etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni.

Në vendin e tretë për nga frekuenca e shkeljeve në përmbajtjen mediatike është neni 10 i Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë, i cili i referohet gjuhës së urrejtjes. Gjithsej 8.7% e të gjitha vendimeve të Komisionit të Ankesave në KEMM, në dhjetë vitet e fundit, kanë të bëjnë me shkelje të kësaj dispozite të Kodit, sipas të cilës gazetarët/mediat jo vetëm që pritet të mos krijojnë apo përpunojnë me vetëdije informacione që kërcënojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të mos përdorin gjuhën e urrejtjes, por, siç thuhet në Udhëzimet për raportimin etik në mediat online, ata duhet të përpiqen të rrisin ndërgjegjësimin për pasojat negative të gjuhës së urrejtjes, të identifikojnë dhe ekspozojnë gjuhën toksike.



Duke qenë se mbi 90% e ankesave të ardhura në Këshilli i Etikës në Media kanë të bëjnë me portalet në internet, udhëzimet për zbatimin e nenit 10 të Kodit në mediat online japin drejtime shumë të qarta se si duhet të veprojnë gazetarët nëse janë në hamendje gjatë raportimit:

10.1. Duke pasur parasysh rrezikun për individët, grupet ose shoqërinë në tërësi, mediat online asnjëherë nuk do të nxisin urrejtje ose mostolerancë bazuar në racën, ngjyrën e lëkurës, origjinën, përkatësinë kombëtare ose etnike, gjininë, seksin, orientimin seksual, identitetin gjinor, përkatësinë në grup të margjinalizuar, si dhe bazuar në gjuhën, origjinën shoqërore, arsimin, fenë ose besimin, bindjen politike apo bindje tjetër, aftësinë e kufizuar, moshën, statusin familjar ose martesor, statusin pronësor, gjendjen shëndetësore, statusin personal dhe statusin shoqëror, ose ndonjë bazë tjetër.

10.2. GGjatë raportimit për problemet e grupeve dhe komuniteteve të ndryshme në shoqëri, mediat online do kenë qasje me shumë kujdes, do të përdorin terminologji të saktë dhe të standardizuar dhe nuk do të përdorin komente fyese ose shprehje me të cilat në mënyrë të pavetëdijshme do të krijojnë ose forcojnë stereotipet për ta.

10.3. Mediat online do të përpiqen të rrisin ndërgjegjësimin për pasojat negative të gjuhës së urrejtjes, do të identifikojnë dhe ekspozojnë një fjalor të tillë, si dhe do të shfaqin aktorët që prodhojnë dhe e përdorin atë. Mediat online do të krijojnë përmbajtje me të cilat do të kundërshtojnë gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin mbi baza të ndryshme.

10.4. Mediat online janë përgjegjëse për rishikimin dhe heqjen e shpejtë të komenteve të përdoruesve që publikohen nën storiet gazetareske në ueb faqet ose rrjetet sociale, të cilat përmbajnë gjuhë urrejtjeje dhe kanë potencialin të shkaktojnë pasoja të dëmshme në shoqëri.

10.5. Në raste të jashtëzakonshme të gjuhës ekstreme të urrejtjes nga individë ose grupe, obligim i medias online është të kritikojë publikisht qëndrimet e tyre, duke theksuar pasojat e dëmshme për komunitetin e gjerë dhe grupet ndaj të cilëve ato janë adresuar.

Ndërgjegjësim më i madh dhe rritje e aktivizmit kundër gjuhës së urrejtjes në përmbajtjet mediatike

Shkalla e shkeljeve të nenit 10 të Kodit të Gazetarëve në përmbajtjen mediatike, nëse ndjekim shifrat për ankesat me bazë të dekadës së fundit, është mjaft e ndryshueshme. Përqindja ka qenë veçanërisht e ndryshueshme në vitet e fundit, kështu që nëse në vitin 2021 ishte 8,3% e totalit të vendimeve të marra, në vitin 2022 ka rënie në 5,06%, ndërsa në vitin 2023 pasoi rritje në 18,07% të vendimeve totale të Komisionit të Ankesave.

Ky kërcim në vitin 2023 mund të jetë për shkak të ndërgjegjësimit dhe angazhimit më të madh të organizatave joqeveritare dhe aktivistëve që avokojnë për respektimin e të drejtave të pjesëtarëve të komunitetit LGBTQI+ në Maqedoni, të cilët kohët e fundit janë duke vepruar si një lloj "rojtari"(watchdog) që përdor mekanizmin e vetërregullimit të medias për të ngritur përgjegjësinë e ekipeve mediatike, veçanërisht kur bëhet fjalë për heqjen e komenteve në rrjetet sociale, të shkaktuara nga përmbajtja mediatike.

Lidhur me këtë udhëzim (neni 10.4 i Udhëzimeve për raportimin etik në mediat online), në këtë moment ekzistojnë dallime serioze mes gazetarëve/redaktorëve të mediave online në vend dhe organit vetërregullues, konkretisht Komisionit të Ankesave pranë KEMM. Në disa raste, përfaqësues të mediave online kanë pohuar se e kanë të pamundur të kontrollojnë dhe fshijnë komentet toksike që pasojnë nën përmbajtjet e tyre mediatike të postuara në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, TikTok, X etj.), se për këtë nuk kanë staf apo para të mjaftueshme për të paguar gazetarët që do të punonin ditë e natë për të pastruar komentet e gjuhës së urrejtjes. Ata madje theksojnë nevojën për trajnime për shumicën e gazetarëve, që ata të mund të bëjnë saktë dallimin midis gjuhës së urrejtjes dhe fyerjes ose diskriminimit, pa cenuar lirinë e shprehjes - diçka që ndonjëherë nuk është mjaft e qartë as për gjyqtarët. Si argument për anën e tyre, ata japin shembuj se disa qindra komente mund të postohen nën ndonjë përmbajtje apo video "joshëse", e cila, sipas përfaqësuesve të mediave online, praktikisht është e pamundur të moderohet. Madje, ata aludojnë se me gjuhën e urrejtjes që mund të përhapet në rrjetet sociale, pavarësisht nëse është e nxitur nga përmbajtje mediatike, duhet të merren institucionet shtetërore - policia dhe prokuroria, e jo gazetarët. Ose, thjesht sugjerojnë që të pritet që zgjidhjen të gjejnë vetë platformat e mëdha, me ndihmën e inteligjencës artificiale.

Faktin se përhapja e gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale sanksionohet edhe me Ligjin për shërbimet digjitale (Digital Services Act) të Bashkimit Evropian[4] që është në fuqi që nga fillimi i vitit 2024, për momentin vështirë se dikush dëshiron ta dëgjojë në Maqedoni, ndoshta sepse pasqyrimi i legjislacionit evropian te ne, si një vend që është ndalur në pragun e negociatave për anëtarësim, nuk është prioritet në të ardhmen e afërt.

Bashkimi Evropian, me Ligjin për shërbimet digjitale, synon për një hapësirë interneti më të sigurt, më transparente dhe më të drejtë, duke mbrojtur të drejtat dhe vlerat themelore të përdoruesve - dinjitetin, autonominë dhe privatësinë e tyre në epokën digjitale, duke mbajtur në të njëjtën kohë platformat e mëdha të internetit të përgjegjshme. Përpjekjet për të parandaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes në internet, sipas Ligjin për shërbimet digjitale (DSA), përfshijnë moderimin e detyrueshëm të përmbajtjes në faqet e internetit dhe rrjetet sociale, për të mbrojtur individët dhe vlerat demokratike, pa cenuar lirinë e fjalës dhe të drejtën për të pasur qasje në informacion.

Pikërisht për shkak të komenteve në internet, e jo për shkak të përmbajtjes mediatike, në disa raste ka reaguar Shoqata për minoritete seksuale dhe gjinore "Qendra Queer" – Shkup, duke paraqitur ankesa për përhapjen e gjuhës së urrejtjes përmes rrjeteve sociale në Komisionin pranë KEMM. Njëra prej ankesave të këtij viti ka të bëjë me një njoftim në portalin Reporter.mk për vdekjen e aktorit Majk Heslin, ose, siç pretendon ankuesi, për një dozë të madhe të gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes në komentet në profilin e kësaj medie në Facebook:

"Diskriminimi në bazë të orientimit seksual, siç është sugjerimi se homoseksualët nuk do të shkojnë në parajsë, është një formë e gjuhës së urrejtjes dhe mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme psikologjike, duke përfshirë frikën dhe depresionin. Komentet përmbajnë urrejtje, paragjykime ose kërcënime të bazuara në orientimin seksual."

Më tej, në ankesë thuhet se portali duhet të ketë moderim aktiv që do të identifikojë dhe heqë komentet që përmbajnë gjuhë urrejtjeje ose diskriminim.

Media nuk ka dorëzuar përgjigje në KEMM pasi është njoftuar nga Zyra Ekzekutive për ankesën, pas së cilës Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar rastin dhe ka konstatuar se ankesa ishte me bazë, pra artikulli me titull "Aktori Majk Heslin vdes nga sulm në zemër në moshën 30 vjeçare, para një ditë po zgjidhte emra për foshnjë", e publikuar nga Reporter.mk më 6.07.2024, nuk devijon nga standardet profesionale dhe etike, mirëpo publikimi i atij teksti në profilin e medias në rrjetin social Facebook devijon:

"Komisioni konkludoi se komentet e lexuesve nën publikimin e tekstit në profilin e medias në Facebook përmbajnë deklarata të gjuhës së urrejtjes, gjegjësisht gjuhë diskriminuese bazuar në orientimin seksual. Media ka pasur për detyrë të reagojë dhe të largojë komente të tilla për të mos nxitur apo përforcuar urrejtjen dhe diskriminimin ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti. Pretendimet e ankuesit janë të justifikuara dhe të pranueshme për Komisionin. Komisioni vëren se me veprime të tilla media ka shkelur dispozitat 10.1; 10.3 dhe 10.4 të Udhëzimeve për raportim etik në media, që dalin nga neni 10 i Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë".

Transmetimet e komunikatave partiake "nga A deri në Zh" - media si platformë për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit

Përvoja e Komisionit të Ankesave tregon se shumë prej personave që krijojnë përmbajtje (jo gjithmonë gazetarë) në një nga mbi 250 mediat online në vend (aq sa janë regjistruar në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve këtë vit duke pritur para nga buxheti për reklama politike me pagesë), përveç 39 stacioneve televizive, 38 stacioneve radiofonike dhe 11 mediave të shkruara, nuk zbatojnë as rregullat bazë gazetareske kur bëhet fjalë për transmetimin e njoftimeve partiake.

Kështu, duke përcjellë "nga A deri në Zh" njoftimin e partisë Integra, në maj 2023, sipas ankuesit – Koalicioni për të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara MARGJINAT[5], portali A1ON.mk, në artikullin me titull "Integra: Presioni i pashembullt ndaj publikut me fushata mediatike LGBTQI+", ka shërbyer si platformë për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, pa qëndrim kritik apo dënim:

"Flitet për transmetimin e një deklarate të partisë politike Integra që përmban gjuhë të urrejtjes ndaj personave LGBTQI+, gjegjësisht gjuhë të urrejtjes dhe diskriminim

në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për një deklaratë "të tjetërkujt", duke e transmetuar atë, media përhap gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin. Deklarata i portretizon njerëzit LGBTQI+ si të çoroditur, të këqij, të panatyrshëm, të paligjshëm, se janë një e keqe që duhet çrrënjosur. Gjuha në deklaratë është një shembull tipik i gjuhës së urrejtjes që duhet të kufizohet në shoqëritë demokratike."

Redaksia e portalit A1ON.mk në përgjigjen e saj e interpreton ankesën si tentativë për censurë nga "Margjinat" kur bëhet fjalë për komunitetin LGBTQI+:

"A1on po përcjell një komunikatë të një partie dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë edhe në të ardhmen pa kërkuar mendimin e organizatave joqeveritare se si duhet të raportojë. Çdo qëndrim është i rëndësishëm për ne. Në rastin konkret nuk ka thirrje për dhunë, ka kualifikime që dëgjohen përditë për grupe të ndryshme të shoqërisë, por është gjithmonë problematike nëse ato i referohen komunitetit LGBT. A1on nuk është gjithmonë dakord me pikëpamjet e shprehura, por kjo nuk do të thotë që ne nuk do t'i përcjellim ato në publik."

Megjithatë, Komisioni i Ankesave pranë KEMM konstatoi se ankesa nga MARGJINAT ishte e bazuar dhe se teksti ishte në kundërshtim me nenin 10 të Kodit të Gazetarëve.

Në periudhën para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në maj 2024, ishim dëshmitarë të shumë devijimeve të tjera nga rregullat e gazetarisë për raportim të saktë, të drejtë dhe të paanshëm, veçanërisht në bazë gjinore.

Analiza e publikuar nga Instituti për Studime të Komunikimit (ISK) me titull "Barazia gjinore në kohën e dezinformatave gjinore" [6] konkludon që në fillim se "mediat kanë mundësuar një përfaqësim të gjerë të narrativave anti-gjinore në hapësirën mediatike, duke kontribuar kështu në vendosje dhe përhapje të dezinformatave gjinore në raportim të ngjarjeve në lidhje me projekt-ligjin për barazi gjinore dhe ndryshimet në Ligjin për regjistrimin amë."

Analiza bazohet në raportet gazetareske për ngjarjet në lidhje me Paradën e Krenarisë në Shkup në maj 2023 dhe protestën e organizuar nga Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM) dhe organizata të tjera konservatore dhe fetare një muaj më vonë. Janë analizuar mbi 1000 raporte online dhe 7000 komente mbi përmbajtjen mediatike të publikuara në Facebook.

"Kur bëhet fjalë për dezinformimin, nga analiza mund të shohim se media nuk i përmbahet udhëzimeve për raportimin etik të mediave online. Duke marrë parasysh se shumica e raportimeve janë reduktuar në raportim të thatë të deklaratave dhe njoftimeve, më së shpeshti duke përfshirë vetëm njërën nga palët kundërshtare, mediat reduktohen në transmetues të thjeshtë të "fakteve të servirura". Raportet gazetareske nuk hyjnë më thellë në përmbajtjen e deklaratave të transmetuara, nuk japin një rishikim kritik, pra është e qartë se pretendimet që transmetohen nuk janë verifikuar. Në këtë mënyrë mediat nuk e lejojnë audiencën të bëjë dallimin mes fakteve dhe dezinformatave…Përveç kësaj, gazetarët vënë fokusin në lajme nga të cilat mund të riprodhohen titujt sensacionalistë", thuhet në përfundimin e këtij punimi.

Rrjetet sociale, podkastet, YouTuberët, ndikuesit (influencers) – sfida të reja madhore si për median ashtu edhe për të drejtat e njeriut

Në një epokë të zhvillimit të shpejtë teknologjik, kur komunikimet mes "medias" dhe publikut po marrin përkufizime të reja, respektimi i standardeve profesionale dhe normave etike në raportim është një sfidë gjithnjë në rritje. Në kushte të mosrregullimit, jo vetëm të mediave online, por edhe të të gjitha burimeve të tjera të informacionit online (YouTuberëve, ndikuesve, podcasterëve, TikTokerëve...) ku është fokusuar pothuajse tërësisht e publiku i të rinjve, nuk mund të gjinden plotësisht as organizatat e mëdha ndërkombëtare, e jo vetëm organizatat e brishta të shoqërisë civile si këshillat e etikës me sanksionet e tyre morale dhe mekanizmat vetërregullues.

Mbrojtja dhe përkushtimi për respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha sferat mbetet detyrë kryesore e mediave, por tashmë edhe e rrjeteve të mëdha sociale, të cilat kanë dëshmuar se luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik të qytetarëve. E drejta e lirisë së shprehjes nuk duhet të rrezikohet, si themeli i vlerave demokratike, por, në të gjithë këtë shpërthim të informacionit në të gjitha kanalet, është e nevojshme një përgjigje e koordinuar nga shumë palë të interesuara (institucionet shtetërore dhe sektori joqeveritar) për të parandaluar shpërthimin edhe të dezinformimt dhe gjuhës së urrejtjes. Mbështetja për programet e arsimimit mediatik dhe digjital do t'i fuqizojë përdoruesit e burimeve të informacionit në internet për të njohur, parandaluar dhe penguar përhapjen e narrativave dhe propagandës së dëmshme.

Bashkimi Evropian miratoi ligjin EMFA (European Media Freedom Act)[7] për të garantuar mbrojtjen e lirisë së medias dhe pluralizmit në vendet e BE, dhe Brukseli pret që ky legjislacion të zbatohet edhe në vendet kandidate për anëtarësim. EMFA mbron pavarësinë e gazetarisë dhe medias nga presionet politike dhe ekonomike, si dhe nga çdo ndërhyrje në politikën editoriale. EMFA bën thirrje për transparencë në pronësinë e medias për t'i ofruar publikut një pamje të qartë se kush zotëron dhe kontrollon median. Ky ligj nxjerr në pah rëndësinë e sigurisë së gazetarëve, offline dhe online, veçanërisht në kohën e kërcënimeve të shtuara dhe mbikëqyrjes së fshehtë.

Në rrethana të tilla, më e pakta që pritet është që gazetarët dhe mediat të kujdesen në mënyrë të barabartë për të drejtat e të gjitha komuniteteve të tjera, pavarësisht nëse janë të vogla, të mëdha, etnike, fetare, gjinore apo shëndetësore.

(Autorja është drejtoreshë ekzekutive e Këshillit për Etikë në Mediat në Maqedoni)

Referencat:

1 Vendimi i Komisionit për Ankesa të Këshillit të etikës në media të Maqedonisë në bazë të një ankese të pranuar nga Katerina Stanishleviq, në dispozicion në: https://complaints.semm.mk/wp-content/uploads/Odluka-Katerina-Stanishlevikj-za-TV-21.pdf

2 Shih: Informacion statistikor (nga krijimi i Komisionit të Ankesave deri më tani), në dispozicion në: https://complaints.semm.mk/

3 Udhëzime për raportimin etik në mediat online (Zbatimi i Kodit të Gazetarëve në sferën online), në dispozicion në: https://semm.mk/wp-content/uploads/2021/03/Ethical_Guidelines_AL.pdf

4 Akti i Shërbimeve Digjitale të Bashkimit Evropian, në dispozicion në: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/priorities-2019-2024/europe-fit-digital-age/digital-services-act_en

5 Vendimi i Komisionit për Ankesa të Këshillit të etikës në media të Maqedonisë në bazë të ankesës së pranuar nga Koalicioni për të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara MARGJINAT – Shkup, në dispozicion në: https://complaints.semm.mk/wp-content/uploads/Odluka-Marginiza-A1on-mk.pdf

6 "Analiza e përmbajtjes me bazë gjinore: Barazia gjinore në një kohë të keqinformimit gjinor", autorë Bojana Jovanovska, Jovana Jovanovska, Instituti për studime të komunikimit, 2023, në dispozicion në: https://cdn.iks.edu.mk/wp-content/uploads/2023/10/rodovata-ednakvost-vo-vreme-na-rodovi-dezinformacii.pdf

7 European Media Freedom Act, në dispozicion në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32024R1083

2. RRJETET SOCIALE, PORTALET E INTERNETIT DHE GJUHA E URREJTJES

Shkruan: SLLAVICA ANASTASOVSKA

1. Hyrje

Në botën e sotme digjitale, mediat sociale luajnë një rol qendror në krijimin, shpërndarjen dhe konsumimin e informacionit. Megjithatë, ky revolucion digjital ka sjellë edhe sfida serioze, veçanërisht në kuadrin e rregullimit të përmbajtjeve të publikuara në internet. Pyetjet në lidhje me përgjegjësinë e platformave për përmbajtjen e krijuar nga përdoruesit janë gjithnjë e më aktuale, pasi mediat sociale bëhen një fushëbetejë kryesore për përhapjen e dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe formave të tjera të abuzimit.

Në kontekstin e të rinjve, të cilët janë ndër përdoruesit më aktivë të rrjeteve sociale, çështja e arsimimit mediatik është kyçe. Hulumtimet tregojnë se të rinjtë janë të ndjeshëm ndaj dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes, gjë që tregon nevojën për edukim më të madh mbi të menduarit kritik dhe përdorimin e përgjegjshëm të platformave digjitale. Ekzistojnë gjithashtu iniciativa globale për rregullimin e përmbajtjes në internet, si Akti Evropian i Shërbimeve Digjitale (DSA) dhe politika të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, të cilat synojnë të krijojnë një ekuilibër midis lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes nga abuzimi.

Në vitin 2024, Komiteti i Helsinkit zbatoi një hulumtim në lidhje me të drejtat digjitale - Vlerësim i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve te nxënësit e shkollave të mesme[1], në të cilin 49% e të anketuarve treguan se nuk kishin marrë edukim formal mbi arsimimin mediatik, 19,5% e të anketuarve treguan se nuk janë të njohur me mekanizmat që ekzistojnë për raportimin dhe luftimin e lajmeve të rreme dhe dezinformatave në platforma të caktuara online, dhe 60% e të anketuarve besojnë se edukimi i arsimimit mediatik duhet të jetë pjesë e detyrueshme e kurrikulës shkollore.

Megjithatë, në një ortek informacionesh dhe shkëmbimesh në hapësirën online dhe në rrjetet sociale, përveç gjuhës së urrejtjes që përhapet përmes postimeve nga profilet private, portalet e internetit harrojnë detyrimin për të moderuar komentet që paraqesin përhapje të gjuhës së urrejtjes, përçmim dhe nxitje të dhunës ndaj grupeve të caktuara.

Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në rastin e vitit 2015 "Delfi AS kundër Estonisë" është një precedent që e hapi këtë diskutim, duke ngritur pyetjen: Deri në çfarë mase duhet të jenë përgjegjës portalet e internetit për përmbajtjen e publikuar nga përdoruesit e tyre?

2. Metodologjia

Kjo analizë synon të japë një pasqyrë kritike të situatës në hapësirën online, me theks të veçantë në diskursin në mediat sociale dhe me fokus kryesor gjuhën e urrejtjes që nuk ka arritur të moderohet nga portalet online.

Sipas të dhënave nga ueb platforma e Komitetit të Helsinkit për regjistrimin e gjuhës së urrejtjes, www.govornaomraza.mk, Në periudhën nga 1 janari deri më 30 tetor 2024 janë regjistruar gjithsej 1.171 raste. Format më të zakonshme të gjuhës së urrejtjes këtë vit lidhen edhe me përkatësinë etnike dhe nacionale, e ndjekur nga afër nga gjuha e urrejtjes drejtuar personave LGBTQI+.

Analiza thekson se moderimi i postimeve dhe komenteve që bëhen virale përbën një sfidë të konsiderueshme për platformat online, por ato gjithashtu përfaqësojnë shkelje nga krijuesit e përmbajtjes. Prandaj, teksti fokusohet në shembuj konkretë nga praktika e shkeljeve që ndodhin në këtë fushë, veçanërisht në tema që shkaktojnë paragjykime dhe gjenerojnë gjuhë të urrejtjes, e cila është e dukshme në komentet në rrjetet sociale.

3. Tendencat aktuale dhe shembuj të gjuhës së urrejtjes në internet

Nga puna e Komitetit të Helsinkit dhe nga rastet e regjistruara këtë vit janë evidentuar tendenca që lidhen me sistemin socio-politik. Nga janari deri në tetor të vitit 2024, gjuha e urrejtjes në Maqedoninë e Veriut u rrit ndjeshëm, veçanërisht bazuar në përkatësinë etnike, politike dhe orientimin seksual.

Periudha parazgjedhore solli një intensifikim të tensioneve etnike, ndërsa gjuha e urrejtjes u nxit edhe nga deklaratat etno-nacionaliste të liderëve politikë. Komuniteti LGBTQI+ ishte i ekspozuar ndaj sulmeve homofobike, veçanërisht gjatë Muajit të Krenarisë - qershor. Kërcënime dhe komente ofenduese janë vërejtur gjithashtu në mediat sociale, shpesh të drejtuara ndaj grave, transgjinorëve dhe personave interseks. Episodet e gjuhës së urrejtjes ndëretnike u nxitën edhe më shumë nga disa incidente, si ndërrimi i flamurit në Korabin e Madh dhe thyerja e pllakës përkujtimore në Karpallëk, apo incidentet e fundit me flamujt në fund të muajit nëntor.


Komiteti i Helsinkit ka reaguar rregullisht duke ngritur kallëzime penale kundër individëve që përhapin urrejtje në internet dhe bëjnë thirrje për dhunë. Megjithatë, rrjetet sociale mbetën një burim kryesor për përhapjen e dezinformatave dhe nxitje të urrejtjes, dhe e konfirmuan edhe më tej praninë e stigmatizimit dhe diskriminimit në shoqëri.

4. Raste të regjistruara në platformën www.govornaomraza.mk

4.1 Nxitja e urrejtjes dhe dhunës ndëretnike në komentet në rrjetet sociale

Titulli: Vetëm një ditë pas 23-vjetorit u thye pllaka e mbrojtësve të rënë pranë Karpallëkut (video)[2]

Më 10 gusht 2024 në rrjetin social Facebook, portali Markukule.mk e ka publikuar lajmin për dëmtimin e pllakës përkujtimore të mbrojtësve në afërsi të Karpallëkut. Në këtë lajm janë vërejtur komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe nxitje për dhunë në bazë të përkatësisë etnike.




4.2. Nxitja e gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor përmes dezinformatave dhe sensacionalizmit

Titulli: Mashkull biologjik boksoi me grua në Lojërat Olimpike të Parisit: Italiania e dorëzoi ndeshjen me lot në sy pas 45 sekondash luftë[3]

Portali Markukule.mk më 1 gusht 2024 publikoi përmbajtje me titull sensacionalist "Mashkull biologjik boksoi me grua në Lojërat Olimpike të Parisit: Italiania e dorëzoi ndeshjen me lot në sy pas 45 sekondash luftë". Përmbajtja e publikuar në rrjetet sociale për fitoren e boksieres algjeriane Iman Khelif, për të cilën dolën informacione të pakonfirmuara në media se është një person interseks, shkaktoi gjuhë urrejtjeje dhe gjuhë ngacmuese bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në komentet e lexuesve, të nxitura nga vetë titulli.





4.3 Gjuha e urrejtjes lidhur me Paradën e Krenarisë

Titulli: " Spektakolar të padëgjueshëm!" - Parada e Krenarisë në Shkup[4]

Para dhe pas Paradës së Krenarisë, e cila u mbajt më 22 qershor 2024 në Shkup, në rrjetet sociale u vërejt gjuhë virale e urrejtjes, e cila përmbante rrezikim të sigurisë, kërcënime, thirrje për dhunë dhe ngacmime ndaj komunitetit LGBTQI+. Për shembull, nën publikimin e portalit A1on me titull "Nën moton "Spektakolar të padëgjueshëm!" Sot në Shkup, Parada e pestë e Krenarisë" u regjistruan mbi 1.000 komente negative me urrejtje, fyerje, nënçmim, nxitje për dhunë dhe kërcënime ndaj komunitetit LGBTQI+.

Komiteti i Helsinkit ngriti kallëzim penal kundër 9 personave për komente në rrjetin social Facebook për rrezikim të sigurisë (neni 144 paragrafi 5 i Kodit Penal) dhe për përhapje të gjuhës ksenofobike dhe raciste përmes sistemit kompjuterik (neni 394d i Kodit Penal).

A1on.mk
June 22 ·

Под мотото „Спектакуларно непослушни!“ денеска во Скопје петтата Парада на гордоста



A1ON.MK

„Спектакуларно непослушни“ - Парада на гордоста во Скопје

Под мотото „Спектакуларно непослушни!“ вечерва во Скопје се одржува 5. Парада на гордо...

Aleksandra Vasilevska, Gjorgji Mojsov and 987 others 1.1K comments 10 shares

Trajce Trajanovski
Na kolec site pa se gordejte da vi ebam sortata pederska

Мартин Џегер
More da ispocrkate na toplovo, eden da ne ostane. Mamata pederska / lezbejska .!.

Иван Мак-Метал Велинов
у крв да серете мамата ваша педерска, да даде господ последна да ви биде, само сапун правење од вас

Oliver Papucarov
Samo sapun da ve pravat



4.4 Miratimi i dhunës në familje dhe mbi bazë gjinore në komente në rrjetet sociale

Titulli: Tragjedi në Sllloveni - Burri nga Prilepi qëllon një grua, pastaj i merr jetën[5]

Më 25 shtator 2024, portali Markukule.mk shpëndau lajmin në Facebook për një femicid të kryer në Sllloveni nga një shtetas i Maqedonisë. Në këtë postim janë vërejtur komente që kanë qenë në drejtim të miratimit të femicidit dhe dhunës mbi bazë gjinore.

Komentet e tilla shkaktojnë dëm i cili, para së gjithash, për shkak të nxitjes së dhunës dhe mungesës së dënimit të qartë nga publiku, i dekurajon më tej viktimat që vuajnë dhunën që t'i kundërvihen dhe ta raportojnë atë.

Маркукуле.мк
September 25 ·

Трагедија во Словенија: Прилепчанец застрелал жена, па сам си пресудил



MARKUKULE.MK

Трагедија во Словенија: Прилепчанец застрелал жена, па сам си пресудил - Маркукуле

66 13 comments 11 shares

Most relevant

Vladimir Lisolajski
Duri do Slovenija pojde za da e zastrela PRILEP ne mozeshe

9w **Like** Reply 2

Hajro Paša Siljevic
Vladimir Lisolajski Školski

9w **Like** Reply See translation

Reply to Vladimir Lisolajski

Zlatko Neloski
Arno ja sutnal imalo nesto ami oti toj

9w **Like** Reply

5. Raporti i KPMD: Shumica e rasteve të diskriminimit në informimin publik dhe media

Komisioni për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (KPMD) në Republikën e Maqedonisë së Veriut është organ i pavarur, i cili synon të sigurojë barazi dhe mbrojtje të të gjithë qytetarëve nga çdo formë e diskriminimit. I themeluar në bazë të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ky komision ka mandat të shqyrtojë ankesat e qytetarëve, të kryejë hetime, të propozojë masa për përmirësimin e situatës dhe të ndërgjegjësojë publikun për rëndësinë e barazisë dhe të drejtave të njeriut. Komisioni gjithashtu luan një rol kyç në monitorimin dhe veprimin ndaj ankesave edhe për ngacmimet përmes informimit publik dhe mediave sociale.

Në raportin vjetor të Komisionit[6] është konstatuar se lëndët më të shumta për mbrojtje nga diskriminimi të pranuara në vitin 2023 kanë qenë në fushën e informimit publik dhe mediave (48,18%). Sa i përket rasteve të diskriminimit të vërtetuar në fushën e informimit publik dhe medias, 13 prej tyre (72%) u referohen ngacmimeve dhe/ose gjuhës që shkakton thirrje, nxitje dhe udhëzime për diskriminim në internet. Nga të tjerat, tre raste janë për përmbajtje të publikuara në portalet e internetit dhe dy për deklarata me përmbajtje shqetësuese me bazë diskriminuese të dhëna në një emision televiziv. Bazat diskriminuese të identifikuara më shpesh janë orientimi seksual (61,11%), identiteti gjinor (61,11%), përkatësia kombëtare ose etnike (27,78%) dhe përkatësia në një grup të margjinalizuar (22,22%).

6. Përgjegjësia për komentet e palëve të treta në internet- praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në rastin "Delphi AS kundër Estonisë"[7] (2015) krijon një precedent në lidhje me rregullimin e përgjegjësisë së portaleve të internetit për komentet e publikuara nga palët e treta.

Rasti ka të bëjë me një nga internet portalet më të mëdha të lajmeve në Estoni, i cili ka lejuar komente te artikujt e botuar pa redaktim paraprak. Pas publikimit të një artikulli që ka nxitur komente fyese dhe nënçmuese, GjEDNj konfirmoi se portali ishte përgjegjës për përmbajtjen. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi se ankuesi ka pasur mundësi t›i parashikojë reagimet negative dhe duhej të kishte marrë masa për t'i parandaluar ato, duke theksuar se liria e fjalës nuk përfshin mbrojtjen e gjuhës së urrejtjes ose nxitjen e dhunës. Vendimi thekson se portalet që kanë kontroll mbi përmbajtjen e publikuar duhet të krijojnë mekanizma efektivë për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve. GjEDNj arriti në përfundim se ndërhyrja në lirinë e fjalës ishte proporcionale, legjitime dhe në përputhje me kufizimet ligjore për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, duke theksuar nevojën për një ekuilibër midis lirisë së fjalës dhe të drejtës për privatësi.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) nënvizon se liria e fjalës nuk është absolute dhe se duhet të sigurohet mbrojtja e të drejtave të të tjerëve, përfshirë reputacionin. Kjo imponon një detyrim për portalet e internetit për të marrë masa proaktive për të monitoruar dhe hequr përmbajtjen e paligjshme, veçanërisht kur ato kanë kontroll të konsiderueshëm mbi përmbajtjen në platformat e tyre.

7. Rekomandime

Nga gjetjet dhe shembujt e paraqitur në këtë analizë, mund të nxirren këto rekomandime:

1. Mediat online, pra portalet e internetit, duhet të përditësojnë rregullisht politikat dhe praktikat e tyre në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat vlejnë për publikimet e tyre si dhe për komentet e lexuesve në faqet e tyre në mediat sociale.

2. Përveç detyrimeve ligjore, portalet e internetit janë gjithashtu të detyruar të respektojnë rregullat etike dhe mekanizmat e vetërregullimit, si Kodin e Gazetarëve dhe Udhëzimet për raportimin etik në mediat online, të cilat i detyrojnë që të kontrollojnë rregullisht dhe të heqin menjëherë komentet e përdoruesve të publikuara nën përmbajtjet në faqet e internetit ose në rrjetet sociale që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe kanë potencial për të shkaktuar pasoja të dëmshme në shoqëri;

3. Mediat/portalet online duhet të vendosin rregulla të qarta për komentet dhe të zbatojnë mekanizma efektivë të moderimit, duke përfshirë filtrimin automatik të fjalëve fyese dhe punësimin e moderatorëve për të monitoruar përmbajtjen.

(Autorja është këshilltare ligjore dhe koordinatore e projekteve në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut)

Referencat:

1 L.Pecova-Ilievska, Analiza e rezultateve të hulumtimit lidhur me të drejtat digjitale - Vlerësimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve te nxënësit e shkollave të mesme, 2024, në dispozicion në: https://mhc.org.mk/analyzes/ analiza-na-rezultatite-od-istrazhuvanje-povrzano-so-digitalnite-prava-procena-na-znaenje-veshtini-i-stavovi- kaj-srednoshkolcite/

2 Botim i portalit Markukule në rrjetin social Facebook, në dispozicion në: https://www.facebook.com/ markukule/posts/pfbid02rUuYijzFSGpnx 6jXhm gEhkD3F9V8ncXbCZGQgWELXU BmGnh CwM88YE59DwCpMC8Bl

3 Botim i portalit Markukule në rrjetin social Facebook, në dispozicion në: https://www.facebook.com /markukule /posts/ pfbi d02sB 6WA6 6DEX V3eAYpqwqQ BG Vr zFJrQDZpg KUM vUcK S3q6F VsxW6 C4os76UH yK5J4Ql

4 Botim i portalit A1ON në rrjetin social Facebook, në dispozicion në: https:// www.facebook.com/ story.php?st ory_ fbid=76991 36 8068 2_ 8516&id=2815 96 26 85826 44&rdid= c3rC074 fVm DJmGob

5 Botim i portalit Markukule në rrjetin social Facebook, në dispozicion në: https://www.facebook.com/ markukule/posts /pfbid02K 4DAb WAZ FA HLAw5 j6r HSJH3 uPVgdi6 wB1 q MvNAu D7n LQQ kv33drTSA NvV KY Ai8Mul

6 Raporti i Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, 2023, në dispozicion në: https://kszd.mk/wp-content / uploads/2024/05/ %D0%9 3 % D0% B E%D0%B4% D0%B8 %D1%8 8%D0% B5% D0%BD-%D0%B 8%D0%B7%D0 %B2 %D0%B5 %D1%88%D1%8 2%D0%B0% D1% 98-% D0 %BD%D0% B0-% D0%9A%D0%A1 %D0%97% D0%9 4-%D0%B 7%D0 % B0-2023-%D 0%B3%D0% BE%D0%B4 %D 0% B8%D0%BD % D0%B 0.pdf

7 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Aktgjykimi, "Delphi AS kundër Estonisë", në dispozicion në: https://hudoc. echr.coe.int / eng#{ %22itemid%22:[%2200 1- 15510 5%22]}

3. CENSURA, BOJKOTIMI DHE KUFIZIMI I HAPËSIRËS PËR VEPRIM TË AKTIVISTËVE TË LGBTQI+ DHE ARTISTËVE SI REZULTAT I GJUHËS SË URREJTJES

Shkruajnë: m-r MANJA VELIÇKOVSKA,
m-r GRACIJA ATANASOVSKA,
m-r SARA MILENKOVSKA

1. Gjuha e urrejtjes – rezultat i rritjes së mobilizimeve antigjinore dhe mosveprimit institucional

Për të shqyrtuar fenomenin e gjuhës së urrejtjes në media dhe komunikimin publik, është e nevojshme të vështojmë dy aspekte kyçe që përcaktojnë kontekstin më të gjerë sociokulturor dhe institucional.

Aspekti i parë ka të bëjë me intensifikimin e mobilizimeve antigjinore në Maqedoni, të cilat nxisin linçime publike dhe jo vetëm që forcojnë diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes, por edhe e transformojnë komunikimin publik duke inkuadruar retorika që legjitimojnë këto diskurse si të pranueshme në shoqëri. Këto struktura joformale, të cilat janë të afërta me praktikat "fisnore," krijojnë një atmosferë të jotolerancës dhe përforcojnë kulturën e urrejtjes në shoqëri.

Aspekti i dytë lidhet me inercinë institucionale afatgjate, neglizhimin dhe ndonjëherë inkurajimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes nga institucionet, veçanërisht kur ato janë të drejtuara ndaj LGBTQI+. Kjo gjendje është rezultat i një mosveprimi tradicional institucional, i cili ka krijuar një kulturë të pandëshkueshmërisë dhe normalizimit të praktikave që shkelin të drejtat e njeriut. Institucionet jo vetëm që injorojnë këto probleme, por gjithashtu janë pasive në sigurimin e mekanizmave për mbrojtjen e grupeve të margjinalizuara, duke mundësuar ruajtjen e pabarazive shoqërore[1].

Vazhdimësia historike e mosveprimit institucional, veçanërisht në polici, prokurori dhe gjyqësor, kontribuon drejtpërdrejt në vazhdimin e diskriminimit gjinor dhe gjuhës së urrejtjes. Këto tre shtylla institucionale kanë shfaqur modele të përsëritura të injorimit, mosveprimit dhe njëanshmërisë, duke forcuar armiqësinë ndaj komunitetit LGBTQI+ dhe duke legjitimuar pabarazinë shoqërore. Në këtë mënyrë, institucionet jo vetëm që nuk i ndëshkojnë autorët e gjuhës së urrejtjes, por edhe riprodhojnë padrejtësinë përmes inercisë dhe njëanshmërisë së tyre. Këto dukuri nuk janë rezultate pasive të "mospërfilljes," por janë pjesë e një logjike të vetëdijshme të shtypjes, të internalizuar institucionalisht, e cila minon përpjekjet për përfshirje dhe barazi.

Përveç kësaj, mobilizimet antigjinore[2] nga viti 2021 kanë forcuar dukshëm narrativat e tyre, duke ndikuar në punën e institucioneve dhe duke rritur gjuhën e urrejtjes përmes targetimit strategjik të aktivistëve dhe artistëve LGBTQI+. Këto lëvizje janë aktive në rrjetet sociale, ku nxisin në mënyrë aktive gjuhë urrejtjeje të drejtuar ndaj atyre që

trajtojnë temat LGBTQI+ në veprat e tyre. Prania e tyre në këto platforma rrit frikën dhe censurën, duke kufizuar hapësirën për shprehje të lirë dhe diskurs kritik.

Teksti përdor një metodologji të kombinuar kualitative, e cila përfshin analizë përshkruese dhe hermeneutike kritike si dhe analizë diskursive. Kjo qasje shqyrton rolin e gjuhës në krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve shoqërore të fuqisë, pabarazive dhe ideologjive, duke hulumtuar njëkohësisht se si lëvizjet shoqërore dhe institucionet legjitimojnë ose shtypin diskurset e ndryshme. Të dhënat primare janë mbledhur përmes platformës për dokumentimin e rasteve të Koalicionit MARGJINAT, reagimeve publike dhe hulumtimeve të mëparshme, me fokus në ngjarjet e vitit 2024 dhe lidhjen e tyre të ndërsjellë.

2. Gjuha e urrejtjes dhe zvogëlimi i hapësirës për veprim të aktivistëve LGBTQI+

2.1. Anulohet prania së një aktiviste transgjinore në publik për shkak të gjuhës së urrejtjes

Në prill të këtij viti, Shoqata e Studentëve të Mjekësisë së Maqedonisë (SHSMM) organizoi një ngjarje me titull "Rruga e tranzicionit", me qëllim që t'i afrojë aspektet shëndetësore të tranzicionit mjekësor të personave transgjinorë për studentët e Fakultetit të Mjekësisë. Folësja kryesore e planifikuar për këtë ngjarje duhej të ishte aktivistja për të drejtat e personave transgjinorë, Lilla Miliq, e cila përmes përvojës së saj personale do të prezantonte kompleksitetin dhe nevojat që përfshin procesi i tranzicionit.

Megjithatë, ngjarja u anulua një ditë para mbajtjes së saj, si pasojë e presioneve nga strukturat antigjinore. Këto struktura, të udhëhequra nga figura publike me role në organizata politike dhe qytetare, dhe më saktësisht nga Gordana Goxho, përfaqësuese e grupit "Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve" dhe anëtare e presidiumit të partisë së djathtë dhe pro-ruse Rodina, e orientuan diskursin e tyre antagonist drejt delegjitimimit të temës dhe pengimit të debatit për të në një kontekst akademik. Ky reagim përjashtoi mundësinë për një diskutim të frytshëm dhe konstruktiv brenda komunitetit akademik, duke e zëvendësuar me një retorikë që forcon margjinalizimin e personave transgjinorë dhe nevojat e tyre shëndetësore.

Anulimi i ngjarjes pasqyroi nënshtrimin e institucioneve ndaj presioneve të jashtme dhe ngriti pyetje serioze mbi aftësinë e hapësirave akademike për të mbetur terrene autonome për mendim kritik dhe emancipim shoqëror. Në vend që të shërbente si mundësi për të njohur sfidat komplekse shëndetësore dhe shoqërore me të cilat përballen personat transgjinorë, diskursi publik u shndërrua në një fushatë për shtypjen e dialogut të hapur. Për më tepër, aktorët antigjinorë, në këtë rast, u bënë thirrje dhe udhëzuan prindërit dhe qytetarët për mënyrën se si të reagonin, duke premtuar se reagimet e tyre do të përcilleshin te Fakulteti i Mjekësisë. Thirrjet e tyre për "mirësjellje" ishin vetëm një iluzion i deklarimit për maturi, ndërsa retorika që përdornin nxiste qëllimisht urrejtje, duke krijuar një atmosferë toksike në hapësirën publike.

> "Ne, si qytetarë dhe prindër të ndërgjegjshëm, refuzojmë që fëmijët tanë të marrin pjesë në ligjërata të organizuara nga aktivistët gjinorë dhe i bëjmë thirrje ekipit të SHSMM që të mbajë përgjegjësi për këtë ndërmarrje, përmes së cilës hapet rruga për normalizimin dhe futjen e normave transgjinore në shoqëri. (...)

> Duke pasur parasysh se na kanë bllokuar për të mos mundur të komentojmë, ju inkurajojmë të shkruani një koment të mirëfilltë, pa ofendime dhe pa gjuhë të dhunshme, por me një mospajtim të qartë dhe konciz ndaj gënjeshtrave antishkencore që përhapen në fakultetet tona, në komentet mbi reagimin tonë.» («Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve», Facebook, prill 2024).

Presionet nga lëvizjet kundër gjinore ishin një faktor kyç, por jo i vetmi për anulimin e ngjarjes. Një pjesë e madhe e përgjegjësisë qëndron te organizatorët, të cilët nuk përgatitën një strategji adekuate për përballje me reagimet e pritshme në një mjedis konservator. Në vend që t'i nënshtroheshin vetë-censurës, ata duhet të kishin siguruar një përgjigje që do të ruante dinjitetin dhe të drejtën e personave transgjinorë për shfaqje publike. Në fakt, pas reagimeve në publik, SHSMM kërkoi ndjesë në rrjetet sociale, duke iu drejtuar opinionit dhe Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, duke sqaruar se titulli fillestar i ngjarjes, "Shëndetësia inkluzive për të gjithë», kishte shkaktuar konfuzion te autoritetet e fakultetit për temën e saj të vërtetë, duke e përshkruar anulimin si «keqkuptim».

> "Kërkojmë falje publike për keqkuptimin dhe distancohemi nga kontroversat. Ngjarja nuk ishte kontrolluar siç duhet nga brenda dhe ishte raportuar gabimisht në Dekanat. Si rezultat, ligjërata është anuluar dhe të gjitha postimet e lidhura me të janë mënjanuar" (Shoqata e Studentëve të Mjekësisë së Maqedonisë - SHSMM, Facebook, prill 2024).

Në kaosin e dezinformatave dhe gjuhës së urrejtjes, më të prekurit nga censura nuk ishin as Dekanati dhe as studentët, ndonëse edhe ata u privuan nga njohuri të rëndësishme, por folësja e ftuar dhe komuniteti më i gjerë transgjinor. Atyre iu dërgua një mesazh i qartë, se trupat dhe identitetet transgjinore nuk i përkasin hapësirës publike. Ky ishte një akt përjashtimi dhe dhune simbolike që forcoi margjinalizimin e tyre, duke shtypur narrativat transgjinore dhe duke mbajtur hapësirën publike si një fushë pabarazie.

Në fakt, brenda vetëm një ore, aktivistja mori qindra komente shqetësuese të mbushura me gjuhë urrejtjeje, të drejtuara drejtpërdrejt ndaj saj. Rasti u dokumentua nga Koalicioni Margjinat dhe u raportua te Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, e më vonë edhe në Prokurorinë Publike. Pasojat e këtij agresioni online ishin thellësisht traumatike për Miliq, e cila përjetoi dhimbje të fuqishme psikologjike, përfshirë frikën, turpin dhe ndjenjën e dinjitetit të cenuar. Ky përjetim rriti nivelin e saj të ankthit dhe e detyroi të tërhiqej dukshëm nga hapësira publike. Ajo iu nënshtrua vetë-censurës dhe e fshiu profilin e saj në Facebook si përpjekje të fundit për mbrojtje nga sulmet e mëtejshme. Kjo situatë tregoi se si hapësira digjitale, që supozohet të shërbejë për shkëmbim të lirë të opinioneve, mund të bëhet një mjet dhune që kufizon dhe shuan të drejtat e individëve, veçanërisht të atyre që janë mbrojtës të të drejtave të njeriut. Përmes përjashtimit sistematik të viktimave, sulmet e tilla mbyllën hapësirën për debat publik dhe normalizuan frikën si metodë për të heshtur mendimet ndryshe.

Kjo retorikë stigmatizoi komunitetin transgjinor dhe i largoi institucionet nga temat që sfidojnë normat tradicionale gjinore. Duke iu nënshtruar këtyre presioneve, institucionet akademike legjitimuan përjashtimin dhe pabarazinë, duke ngushtuar më tej hapësirën veçmë të kufizuar për mbrojtjen e të drejtave të personave transgjinorë. Ky akt krijoi një efekt frikësimi, duke dekurajuar studentët dhe profesorët që të angazhohen në çështje kritike mbi gjininë dhe shëndetin, duke rrezikuar më tej përpjekjet për barazi gjinore në një mjedis shoqëror armiqësor.

Nga ana tjetër, anulimi i ngjarjes u dënua nga Instituti për Studime Gjinore dhe aktivistët për të drejtat e njeriut, të cilët e cilësuan atë si një sulm ndaj lirisë akademike dhe diskursit shkencor. Ata theksuan vendimin si një simptomë të censurës më të gjerë dhe margjinalizimit të temave shëndetësore për personat transgjinorë në arsimin mjekësor, nën ndikimin e ideologjive antigjinore që paraqesin të drejtat transgjinore si të kontraverse dhe të dëmshme.

Rasti gjithashtu u raportua në Prokurorinë Publike përmes Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, i cili ngriti kallëzim penal kundër personit juridik "Shoqata Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve" dhe ndaj Gordana Goxho, për shpërndarje të materialeve raciste dhe ksenofobike përmes sistemit kompjuterik, sipas Nenit 394-g nga Kodi Penal. Kallëzimi kishte të bënte me postimet dhe komentet që përmbanin gjuhë të urrejtjes në rrjetin social Facebook dhe bënin thirrje për diskriminim dhe armiqësi ndaj komunitetit trans. Mirëpo, në këtë rast, Prokuroria Themelore Publike konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se është kryer vepra penale, gjegjësisht se postimet në rrjetet sociale nuk përmbajnë elemente që mund të plotësojnë thelbin juridik të veprës penale të përhapjes së materialeve raciste dhe ksenofobike, dhe për më tepër përcaktoi se "komuniteti trans nuk është i rregulluar zyrtarisht dhe ligjërisht në legjislacionin kombëtar". Rrjedhimisht, Prokuroria Publike konstaton se postimet në Facebook nuk kishin për qëllim përhapjen e urrejtjes, diskriminimit apo dhunës ndaj këtij komuniteti. Thënë shkurt, kallëzimi penal u hodh poshtë nga Prokuroria Themelore Publike për shkak të mungesës së elementeve të veprës penale dhe provave të vërtetuara[3]. Të njëjtin mendim më pas e konfirmoi edhe Prokuroria e Lartë Publike, e cila e refuzoi ankesën dhe e konfirmoi vendimin e Prokurorisë Themelore Publike.

Këto dy vendime dëshmuan në mënyrë simbolike se në një shoqëri ku të drejtat e grupeve të caktuara nuk njihen shprehimisht në ligj, ekzistenca e tyre mund të mos njihet dhe të mohohet, gjë që normalizoi në mënyrë eksplicite përjashtimin dhe dhunën ndaj tyre. Anulimi i "Rrugës së tranzicionit" ekspozoi mbizotërimin në rritje të politikës antigjinore, e cila u infiltrua jo vetëm në diskursin publik, por edhe në proceset vendimmarrëse institucionale.

Këto politika, të cilat i kanë rrënjët në qëndrimet opozitare ndaj barazisë gjinore dhe të drejtave LGBTQ+, kanë heshtur në mënyrë aktive diskutimet për identitetin gjinor dhe kanë shtypur progresin e të drejtave transgjinore. Anulimi i ligjëratës nuk ishte një ngjarje e izoluar, por u bë pjesë e një tendence më të gjerë të përjashtimit të institucionalizuar që ngushton hapësirën për dialog kritik dhe progres lidhur me çështjet gjinore. Ky akt pasqyronte një strategji strukturore për të ruajtur hegjemoninë e normave tradicionale, me qëllim që të ngulfaten zërat alternativë dhe të minimizohet legjitimiteti i narrativave transgjinore në sferën publike.

2.2. Përpjekje për mohimin e suksesit të personave transgjinorë për shkak të gjuhës së urrejtjes

Në dhjetor të vitit 2024, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u nda çmimi shtetëror "Meto Jovanovski". Ky çmim, që simbolizon përkushtimin për avancimin e të drejtave të njeriut, iu dorëzua Shoqatës "Qendra për Komunikime Qytetare (QK!)" dhe aktivistes Lilla Miliq. Miliq u zgjodh si fituese e këtij çmimi për angazhimin e saj në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit transgjinor. Për të, ky akt ishte më shumë se një gjest simbolik – ishte një akt

politik që krijoi hapësirë për një dukshmëri më të madhe të komuniteteve të margjinalizuara, veçanërisht për personat transgjinorë në vendin tonë.

> "Ky çmim nuk është vetëm një njohje për përpjekjet e mia, por edhe një mesazh që drejtësia, barazia dhe gjithëpërfshirja janë të mundshme. Është një dëshmi që çdo njeri, pavarësisht identitetit, mund të jetë pjesë e progresit shoqëror. Edhe pse sot nuk jam fizikisht e pranishme, zëri im gjithmonë do të jetë me ata që luftojnë për drejtësi dhe barazi. Prandaj, nga ky moment shkruajmë një histori të re – histori të dukshmërisë, krenarisë dhe njohjes," deklaroi Lilla Miliq në fjalimin e saj që u lexua në Kuvend në ditën e ndarjes së çmimit.

Reagimet nga lëvizjet antigjinore, të shprehura përmes rrjeteve sociale dhe letrave drejtuar institucioneve, zbuluan një rezistencë të thellë ndaj të drejtave transgjinore. Pakënaqësia e tyre, veçanërisht në lidhje me fondin financiar të çmimit, theksoi konfliktin midis përpjekjeve për përfshirje dhe diskursit konservator dominues. Kjo ngjarje pasqyroi luftën e vazhdueshme për legjitimimin e grupeve të margjinalizuara në një shoqëri që ende kundërshton ndryshimet, ndërkohë që reagimet e tilla shtuan më tej stigmatizimin dhe ngushtuan hapësirën për debat kritik dhe transformim social.

> "Buxheti u varfërua për 600.000 denarë, të cilat iu dhanë në kesh Lilla Miliqit dhe Qendrës. Populli e kundërshtoi masovikisht këtë maskaradë, por autoritetet nuk kishin veshë për të dëgjuar. Për pacientët e sëmurë nuk ka para, për çizmet e reja të zjarrfikësve nuk ka para, për pajisjet ushtarake nuk ka para, por për aktivistët, të paguar nga Sorosi, që e reklamojnë prostitucionin si punë ekskluzive dhe çrregullimet mendore si diçka normale, shteti ka para." ("Merr përgjegjësi", Facebook, 10 dhjetor 2024)

Komentet e drejtuara ndaj aktivistes transgjinore që mori çmimin shtetëror zbulojnë një përçmim dhe rezistencë të thellë ndaj identitetit të saj dhe punës që ajo përfaqëson. Kjo gjuhë pasqyron një nevojë për t'u kthyer ndaj disa "vlerave tradicionale", të paraqitura përmes një imazhi të idealizuar të së kaluarës, ku identiteti i saj do të përjashtohej ose do të dënohej haptazi. Me pak fjalë, mirënjohja për Miliqin trajtohet si turp për shtetin, që reflekton jo vetëm nivelin e jotolerancës, por edhe paaftësinë e një pjese të shoqërisë për ta pranuar luftën për të drejtat dhe barazinë si legjitime dhe të vlefshme. Ngjashëm, edhe komenti si "gjithçka ka dalë jashtë kontrollit në këtë vend të vogël" e përmbledh perceptimin negativ ndaj tendencave bashkëkohore shoqërore. Shprehjet e tilla janë reflektim i një ndjenje pafuqie dhe zhgënjimi, ku ndryshimet shoqërore perceptohen si "të dëmshme" dhe "të dhimbshme". Këto qëndrime tregojnë për një polarizim të thellë në shoqëri, ku një pjesë e saj e sheh progresin si një largim nga "normaliteti" heteronormativ dhe vlerat tradicionale. Ky fakt thekson nevojën për edukim më të thellë shoqëror dhe përpjekje për të ulur paragjykimet që nxisin këtë urrejtje.

> "Neve, prindërve dhe të gjithë qytetarëve me arsye të shëndoshë të RM-së nuk na mbetet asgjë tjetër, përveçse të kundërvihemi përmes ekspozimit publik të këtyre strukturave, ndikimeve, aktiviteteve dhe financimeve. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë cirku që do të shohim më 10 dhjetor në Kuvend përmes figurës dhe veprës së Lilla Miliqit, një burrë që ndihet si grua, që angazhohet për seksualizimin e hershëm të fëmijëve tanë në arsim, legalizimin e pafund të identiteteve gjinore, dekriminalizimin e prostitucionit dhe barazimin e tij me profesione të tjera, për të qenë një nga zgjedhjet e jetës që fëmijët tanë mund të bëjnë dhe të qenit të 'ndershëm' duke shitur trupin e tyre për të fituar bukën..." ("Fronti Prindëror", Facebook, 6 dhjetor 2024)

Komentet nën postimet e Frontit Prindëror dhe Merr Përgjegjësi, që lidhen me punën e aktivistëve për të drejtat e njeriut, përfaqësojnë një shprehje të qartë të urrejtjes dhe rezistencës së thellë ndaj punës së tyre, me stereotipa, akuza dhe kërcënime të drejtpërdrejta. Përmes përdorimit të metaforave si "ind kancerogjen" dhe "nyja Gordiane", këto reagime përpiqen të delegjitimojnë aktivistët, duke i paraqitur ata si një rrezik shoqëror. Këto shprehje jo vetëm që i etiketojnë aktivistët si destruktivë, por krijojnë iluzionin se puna e tyre ka qëllime të fshehura që gjoja minojnë vlerat tradicionale dhe interesat e qytetarëve të zakonshëm.

Disa komente shkojnë deri te thirrjet e hapura për urrejtje dhe dhunë, duke rrezikuar seriozisht sigurinë e aktivistëve dhe duke nxitur tensione në hapësirën publike. Për më tepër, akuzat se OJQ-të financohen nga burime të huaja si "Sorosi" ose "BE-ja" i portretizojnë aktivistët si instrumente të ndikimeve të jashtme. Kjo e ushqen perceptimin se ata nuk përfaqësojnë interesa lokale, por punojnë në shërbim të ndonjë agjende globale që supozohet se është në kundërshtim me interesin kombëtar. Shprehjet si "kolona e pestë"[4] dhe "i shesin interesat e më të cenuarve" tregojnë një mosbesim të rrënjosur thellë dhe një ndjenjë izolimi shoqëror. Këto fjalë tregojnë se sa lehtë mund të ndahet dhe mobilizohet opinioni përmes retorikës që e lidh luftën për të drejtat e njeriut me komplotet kundër vlerave shoqërore «tradicionale". Reagime të tilla flasin për një konflikt më të madh kulturor në shoqëri, ku frika nga ndryshimi dhe humbja e vlerave tradicionale dominon në perceptimet e një pjese të publikut.

Gjuha agresive në komente, e cila përfshin kualifikime degraduese e bile edhe thirrje për dhunë, është reflektim i frustrimeve të mbledhura dhe pasigurisë sociale. Në vend të kritikës racionale, retorika e tillë është simptomë e tensioneve shoqërore dhe pasigurisë, të cilat përforcohen nga manipulimi politik dhe mediatik. E gjithë kjo e thekson nevojën për të kuptuar më thellë dhe për të promovuar vlerat e të drejtave të njeriut, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin publik për rolin e tyre thelbësor në zhvillimin e shoqërisë.

2.3. Rritje e mbikëqyrjes dhe zhvendosje e Shkollës për të rinjtë LGBTIK dhe aleatët strejt/cis-gjinorë për shkak të gjuhës të urrejtjes

Në fillim të qershorit 2024, organizata joqeveritare "Ekvalis" paralajmëroi mbajtjen e Shkollës Verore për të rinjtë LGBTQI+ në Kratovë. Pas publikimit të thirrjes për pjesëmarrës, ngjarja u përball me një fushatë të ashpër urrejtjeje dhe kërcënimesh në rrjetet sociale, të shkaktuara nga publikime të personazheve publik si Lupço Ristovski, lider i partisë së djathtë «Integra», dhe Gordana Goxho, e përmendur më parë në rastin e Fakultetit të Mjekësisë, të njohur për qëndrimet dhe aktivitetet e tyre antigjinore. Kërcënimet, me të cilave kishte kërcënime për dhunë fizike, shkaktuan tension të shtuar në komunitetin lokal në Kratovë, me të cilin «Ekvalis» kishte bashkëpunim pozitiv për shumë vite, dhe i detyruan organizatorët të zhvendosin shkollën në një qytet tjetër dhe të angazhojnë sigurim 24 orësh për pjesëmarrësit dhe trajnuesit. Për këtë rast, «Ekvalis» me ndërmjetësimin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka paraqitur kallëzim penal kundër Ristovskit, Goxhos dhe disa personave të tjerë të panjohur për shpërndarje të materialeve raciste dhe ksenofobike përmes sistemit kompjuterik dhe për rrezikimin e sigurisë, sipas Kodit Penal.

Në kallëzimin penal, si dëshmi kryesore për shpërndarjen e urrejtjes, "Ekvalis" ka paraqitur statusin e Facebook-ut të Lupço Ristovskit. Në postimin e tij, ai e komenton

pjesën joformale të Shkollës, të titulluar *"Parashikimi i queer tarrotit, lojëra shoqërore dhe shikimi në yje"*.

> "Sipas Biblës, të gjitha këto 'lojëra' janë vepra të djallit vetë dhe për ato parashikohet [sic] fund i frikshëm, po ashtu edhe për ata që i mbështesin, i promovojnë dhe i praktikojnë...këto janë vepra të së keqes." (Lupço Ristovski, Facebook, qershor 2024)

Në vijim të statusit, ai kërkon nga "liderët kishtarë të KOM-AO" së bashku me institucionet dhe komunitetet tjera krishtere në Maqedoninë e Veriut që "të reagojnë ashpër" për këtë ngjarje. (Ristovski L., 2024)

Këto thirrje për "reaksione të ashpra" nga aktorët konservatorë në shoqërinë tonë patën ndikim të madh mbi publikun e gjerë, si dhe mbi ndjekësit e tyre. Si pasojë, punonjësit e "Ekvalis" u sulmuan deri në atë pikë nga fushata e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë, sa që ata morën kërcënime për jetë, dhe për një periudhë, nuk mund të dilnin as nga shtëpia për shkak të frikës për sigurinë e tyre personale.

Për ngarkesën psikologjike, por edhe fizike të këtij *gjahu shtrigash*, folën publikisht edhe Angell Dimitrievski, drejtor ekzekutiv i "Ekvalis", dhe Elena Danova, presidente e "Ekvalis". Dimitrievski ndau përvojën e tij me gjuhën e urrejtjes si diçka që është "ngec në qeliza" dhe shkakton shtrëngim, frikë dhe manifestime fizike, ndërsa Danova foli për traumën kolektive psikologjike që ky rast ka shkaktuar te organizatorët, trajnuesit dhe pjesëmarrësit.

> "Çdo mëngjes, duke u zgjuar me organizimin e kësaj ngjarje, kam pasur frikë të hapja celularin dhe të lexoja mesazhet, email-et dhe kërcënimet që merrnim çdo ditë. Ato komente kanë ngecur brenda meje." (Angell Dimitrievski, "E ngecur në qeliza", Meduza, 2024)

> "Trauma psikologjike mbetet si për trajnuesit, ashtu edhe për pjesëmarrësit. Ata ishin të vetëdijshëm për reagimet dhe kërcënimet për jetë. Ky është rasti më ekstrem, më parë kemi marrë kërcënime ndaj jetës nga adresa email të panjohura, kemi marrë gjuhë urrejtjeje edhe përmes komenteve, mesazheve në rrjetet sociale. Posaçërisht në muajin qershor, kur mbahet Parada e Krenarisë. Kjo është rutinë, gjuha e urrejtjes intensifikohet me kalimin e viteve, e tani morëm kërcënime ndaj jetës. Dhe për një periudhë, nuk guxonim të dilnim nga shtëpia për të mbrojtur veten." - tha Elena Danova për Radion Evropa e Lirë (Petar Klinçarski, *"Jehona e urrejtjes - Kur gjuha e urrejtjes në internet nxit dhunë kundër personave LGBTQI+"*, REL, 2024)

Siç përmendëm më sipër, për fat të mirë, shkolla u mbajt, në një lokacion tjetër sekret, nën sigurim të vazhdueshëm. Është e qartë se kjo nuk mund të jetë e ardhmja e organizimit dhe realizimit të ngjarjeve LGBTQI+. Në frymën e aktivizmit dhe qëndrueshmërisë, një muaj pas kësaj ngjarje të trishtë, ekipi i "Ekvalis" njoftoi se nuk do të tërhiqen nga angazhimet e tyre dhe përpjekjet për një jetë më të mirë për çdo të ri LGBTQI+ në këtë vend, i cili meriton të jetojë "një jetë dinjitoze dhe autentike pa dhunë dhe urrejtje." (Ekvalis, 2024, korrik)

Megjithatë, përveç pasojave të rënda psikologjike nga gjuha e urrejtjes, nuk ka përgjigje nga institucionet. Që nga qershori 2024, kur është paraqitur kallëzimi në MPB,

kanë kaluar gjashtë muaj dhe deri tani ekipi i "Ekvalis" ende nuk ka marrë asnjë përgjigje nga institucionet përgjegjëse për kallëzimin penal të paraqitur. Nga kjo, bëhet e qartë se ky incident, si dhe një seri ngjarjesh të tjera të ngjashme - disa prej të cilave përmenden në këtë tekst - theksojnë nevojën për një mbrojtje më efikase dhe një reagim juridik ndaj gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTQI+ në Maqedoninë e Veriut.

3. Gjuha e urrejtjes kundër artit queer dhe artistëve që merren me tema LGBTQI+

3.1. Censura e artit në institucionet kulturore bashkëkohore për shkak të gjuhës së urrejtjes

Kultura dhe artet shpesh janë në shënjestër të mobilizimeve antigjinore, sepse ato theksojnë rëndësinë e diversitetit, tolerancës dhe barazisë, duke sfiduar kështu vlerat tradicionale. Këta aktorë e konsiderojnë artin si një kërcënim, sepse hap hapësirë për mendimin kritik dhe promovimin e perspektivave alternative që mbështesin barazinë dhe të drejtat për të gjithë. Duke sulmuar këto sfera, ata përpiqen të kontrollojnë prodhimin kulturor, ngjashëm me interesin e tyre për arsimin, të heshtin idetë e ndryshme dhe të ruajnë strukturat shoqërore ekzistuese dhe të prapambetura.

Kështu, gjatë vitit 2023, pati dy raste të rëndësishme të gjuhës së urrejtjes dhe përpjekjeve të censurës që synonin artin letrar me tema LGBTQI+, duke reflektuar polarizimin kulturor në rritje që u përshkallëzua në vitin 2024. Në kontekst të rritjes së sulmeve antigjinore, shprehjet artistike dhe intelektuale janë bërë cak i retorikës që kërkon të imponojë vlera konservatore përmes gjuhës së urrejtjes, duke minuar lirinë e shprehjes. Këto ngjarje nxorën në pah tensionin midis vlerave demokratike dhe përpjekjeve reaksionare për të margjinalizuar diversitetin gjinor dhe seksual.

Në rastin e parë, një bibliotekist nga Libraria Universitare Kombëtare (LUK) ka marrë kërcënime gjatë përgatitjes së ligjëratës *"LGBTQI+ dhe libraritë publike"*. Kërcënimet përfshinin narrativa demonizuese që nxirrnin në pah cenueshmërinë e profesionistëve që përpiqeshin të nxisin vlera gjithëpërfshirëse dhe demokratike. Ky incident zbuloi se si institucionet kulturore po bëhen fusha beteje për ideologjitë antigjinore, duke synuar individë që mbështesin përfshirjen.

Në rastin e dytë, një grup joformal antigjinor bëri thirrje për bojkotimin e shtëpisë botuese "Polica" për shkak të mbështetjes për Paradën e Krenarisë dhe promovimit të veprave të shkrimtarit francez Eduar Luis. Edhe pse bojkoti synohej si një përpjekje për të heshtur, reagimi i publikut ishte i kundërt – libraria mori mbështetje të madhe, duke konfirmuar solidaritetin e qytetarëve me lirinë e shprehjes dhe përfshirjen kulturore.

Këto ngjarje jo vetëm që ekspozuan mungesën e vullnetit të hapësirave kulturore për t'u mbrojtur nga presioni që vjen nga retorika antigjinore, por gjithashtu demonstruan se si solidariteti publik mund të shërbejë si përgjigje ndaj censurës dhe sulmeve ndaj lirisë artistike. Në të njëjtën kohë, ato theksuan nevojën që institucionet kulturore të marrin një rol aktiv në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe promovimin e vlerave gjithëpërfshirëse.

Pas këtyre dy përvojave në vitin 2023, në fillim të vitit 2024, në opinion depërtoi fuqishëm një rast tjetër i gjuhës së urrejtjes lidhur me mbylljen e projektit "Sheqeri i hid-

hur" nga artisti Gjorgje Jovanoviq. Ekspozita, e mbajtur në Muzeun e Artit Bashkëkohor në Shkup nën kuratorin e Vlladimir Jançevskit dhe Bllagoja Varoshanec, ishte një projekt multidisiplinar që, përmes një instalimi hapësinor dhe shfaqjeve të animuara kukullash, eksploroi injorancën dhe kufijtë shoqërorë dhe dekonstruktoi stereotipat, duke inkurajuar dialogun kritik rreth lirisë së shprehjes.

Një pjesë e publikut, e motivuar nga të njëjtat stereotipa që sfidonte ekspozita, sulmoi projektin pesë muaj pas hapjes së ekspozitës. Reagimi i parë ka ardhur nga një person i cili ka postuar një video nga ambientet e muzeut, duke tërhequr vëmendjen në një dhomë të shënuar «16+», ku janë shfaqur pjesë të videove, duke përfshirë një skenë eksplicite nga tregimi «Tableta shkumëzuese» nga Petar Andonovski. Video regjistrimi, nga i cili u morën disa sekonda nga animacioni njëorësh jashtë kontekstit, u postua në Facebook me pretendimin se muzeu po "i ekspozonte qëllimisht fëmijët ndaj përmbajtjes seksuale". Jo shumë kohë pas këtij postimi, një përdorues tjetër postoi një status të ngjashëm, në të cilin ekspozita u prezantua në mënyrë të rreme se përmban përmbajtje pornografike homoseksuale për fëmijë, duke e lidhur atë me vizitat e organizuara për fëmijë të mbajtura në muze.

Këto reagime, të bazuara në interpretime të shtrembëruara qëllimisht dhe në panik moral, zbuluan rezistencën e thellë të një pjese të publikut ndaj temave LGBTQI+ dhe narrativave kritike që vënë në dyshim hegjemoninë e normave tradicionale. Në vend që të nxisnin debat konstruktiv, reagimet e tilla funksionuan si një instrument për diskreditimin e artit bashkëkohor, duke ngushtuar hapësirën e veprimit të ardhshëm për artistët queer në mjedisin lokal, por edhe për ata që do të merreshin me temat LGBTQI+ në artin e tyre. Ngjarja jo vetëm që ndriçoi sfidat me të cilat përballet arti që trajton tema të margjinalizuara, por demonstroi edhe mospërgatitjen e institucioneve për ballafaqim me shtrembërimet publike të synimeve dhe përmbajtjes artistike.

> "Këtu ka filma vizatimorë me përmbajtje pornografike homoseksuale." Sapo hyra në muze, pashë një fëmijë që dilte nga brenda. Po i them babait të tij, nuk e sheh se ka një shenjë? Ai më injoroi. Për 2 minuta kam penguar të hyjnë pesë fëmijë. Dëgjova nga njëra, dhjetë fëmijë ishin brenda më parë. Fola me regjisorin dhe artistin dhe e fikën projektorin, por kjo nuk është zgjidhje. Aty organizohen edhe turne për fëmijë." (Nenad Panovski, Facebook, dhjetor, 2023)

Këto dy postime tendencioze ndezën një diskutim jokonstruktiv nga personat që nuk e kishin vizituar ekspozitën, ku komentet u kthyen në gjuhë të urrejtjes ndaj autorit Gjorge Jovanoviq dhe kuratores Bojana Janeva. Ata u quajtën "të çmendur", "maniakal", "pedofilë" dhe "të sëmurë", kurse Jovanoviq gjithashtu mori kërcënime me vdekje dhe kaloi nëpër një proces që ai e përshkroi si "çmenduri dhe histeri totale". Video-postimi fillestar ishte ribotuar nga faqja antigjinore "Merr përgjegjësi" dhe nga personazhe publike, gjë që rriti më tej presionin ndaj muzeut dhe autorit, kur duhej të zhvillohet evenimenti final promovues para mbylljes së projektit. Rasti nxori në pah toksicitetin e diskursit publik, ku arti, në vend që të nxiste dialogun, u bë cak i fushatave manipuluese që kufizonin lirinë e shprehjes.

> "Ekspozitat frymëzuese në Muzeun e Artit Bashkëkohor nën udhëheqjen e ministres Bisera Kostadinovska-Stojçevska, shoqes së ish-ministres së Punës dhe Politikës Sociale Jovanka Trençevska. Në këtë dhomë u panë edhe fëmijë të vegjël, një grup i tërë! Këtu fajin e kanë edhe prindërit nëse e kanë parë shenjën dhe prapë i kanë futur fëmijët e tyre. Por Ministrja Bisera duhet të mbajë përgjegjësi për

lejimin e qasjes falas për fëmijët e vegjël në një objekt nën menaxhimin e saj, ku shfaqet përmbajtje pornografike" ("Merr përgjegjësi", 15 shkurt 2024, Facebook)

Rasti i Jovanoviqit gjithashtu lidhej qartë me incidentet e mëparshme të gjuhës së urrejtjes, të cilat ishin ndikuar nga retorika antigjinore. Forcat konservatore, të cilat demonizonin sistematikisht të njëjtët individë dhe grupe, vazhduan të nxisin censurën, siç bënë me përkthimet letrare dhe fondet në bibliotekat publike dhe librarit. Por në këtë rast, aktorët antigjinorë shfrytëzuan mllefin ekzistues publik për të nxitur një valë të re paniku moral, duke shënjestruar përmbajtjen kulturore dhe artistike. Ky cikël denigrimi dhe thirrjesh për censurë jo vetëm që e ka vështirësuar hapësirën e shprehjes së lirë kulturore, por ka rrënjosur edhe hegjemoninë e vlerave tradicionale, duke heshtur narrativat alternative artistike dhe kulturore.

"Personazhet që mbronin libra pornografikë ku fëmijë të moshës 9-10 vjeç kryejnë seks në grup dhe ëndërrojnë për nekrofili, tani po mbrojnë filmat vizatimorë pornografikë që fëmijët e vegjël i shikojnë në Muzeun e Artit Modern". Dhe ai mburret se ishte 'arti' i tij!" ("Merr përgjegjësi", 16 shkurt 2024, Facebook)

Nëpërmjet efektit të amplifikimit, aktorët antigjinorë jetësuan sistematikisht dezinformatat, duke manipuluar ndjenjat publike të armiqësisë dhe ankthit. Duke përdorur gjuhë evokative dhe prova të fabrikuara, ata nxitën gjuhën e urrejtjes bazuar në seksualitetin e supozuar të artistit dhe të gjithë atyre që lidhen me të. Ky diskurs, tashmë i njohur nga saturimi i tij në narrativat e "kërcënimeve" nga popullatat LGBTQI+ dhe identitetet e ndryshme gjinore, ishte selektiv dhe i shënjestruar taktikisht. Siç vë në dukje vetë Jovanoviq, "është interesante që në animacionin e bazuar në tregimin e Rumena Buzharovskës kishte [gjithashtu] një skenë seksi heteroseksual, të cilën askush nuk e kundërshtoi" (Jovanoviq, dhjetor, 2024). Duke përzgjedhur me kujdes përmbajtjen që paraqesin, ata kanë përforcuar narrativën e tyre, duke përdorur ekspozitën si një instrument për të legjitimuar stigmatizimin e personave LGBTQI+ dhe shtypjen e shprehjeve kritike kulturore dhe artistike.

Një aspekt shtesë i këtij rasti ishte përdorimi i projektit "Sheqeri i hidhur" i Jovanoviqit si një mundësi e përshtatshme për të përforcuar argumentet e aktorëve antigjinorë. Stili i përdorur, me vizatime dhe animacione që ngjasojnë me ilustrimet e fëmijëve, u interpretua qëllimisht në mënyrë të shtrembër përmes një logjike mendjengushtë antigjinore. Në vend që të ishte një shprehje artistike me mesazhe komplekse, përmbajtja u prezantua para publikut si material i destinuar për fëmijë. Ky manipulim jo vetëm që nxiti dezinformatat, por e përdori edhe vetë shprehjen estetike të projektit për të legjitimuar një panik moral, duke polarizuar më tej diskursin publik dhe duke diskreditur artistin dhe veprën e tij.

"I gjithë koncepti i ekspozitës kishte ikonografi që i afrohej komikut ashtu si dhe ilustrimit, gjë që zemëroi edhe më shumë një pjesë të audiencës, duke menduar se ishte e destinuar për fëmijë. Sigurisht, nuk ishte ky qëllimi", tha Jovanoviq për këtë analizë.

Edhe pse turnet e fëmijëve në Muzeun e Artit Bashkëkohor nuk përfshinin kurrë materiale për audiencë të pjekur, por përmbajtje të kuruar me kujdes të përshtatshme për moshën dhe nevojat arsimore, njohuritë dhe profesionalizmi i kuratorëve, artistit dhe vetë muzeut u dënuan publikisht. Ata u akuzuan për "degjenerim" dhe u bënë cak i thirrjeve publike për dëmtim dhe diskreditim. Situata u përshkallëzua kur faqet antigjinore filluan të shpërndanin montazhe manipuluese dhe kolazhe të fotografive të

vizitave të fëmijëve në muze, duke i lidhur ato me materialet nga ekspozita e Jovanoviqit. Këto montazhe krijuan përshtypjen e rreme se projekti synohej ekskluzivisht për fëmijët, duke intensifikuar më tej panikun moral dhe duke cenuar legjitimitetin e institucionit kulturor. Ky akt zbuloi një strategji të qëllimshme të shtrembërimit të fakteve për të diskredituar lirinë artistike dhe profesionalizmin, duke mbytur njëkohësisht hapësirën për dialog kritik dhe reflektim publik.

> "Në rrjetet sociale u krijuan lajme të rreme dhe gjuhë e urrejtjes të drejtuara ndaj autorit për shkak të orientimit të tij të supozuar seksual. Janë vërejtur komente dhe statuse që demonizojnë komunitetin LGBTQI+, si dhe komente që nxisin dhunë dhe diskriminim. Komiteti i Helsinkit beson se një fjalim i tillë stigmatizon edhe më tej komunitetin dhe ka ngritur dy kallëzime penale kundër tre personave për kryerjen e veprës penale të "Përhapjes së materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik" të përshkruar në nenin 394g të Kodit Penal." (Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2024)

Ky narrativ i korrupsionit moral të fëmijëve, i ankoruar në pretendimet për ekspozim ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, nuk është origjinal, por është pjesë e strategjive globale antigjinore për të minuar politikat progresive socio-politike. Mesazhet dhe kërkesat e aktorëve antigjinorë iu drejtuan Ministrisë së Kulturës dhe Muzeut të Artit Bashkëkohor, duke përfituar nga niveli i ulët i besimit tek institucionet për të neutralizuar pozicionin e muzeut dhe për të heshtur shpjegimet e Vërtetmatësit dhe vetë Jovanoviqit.[5]

Bashkëpunimi aktual i Qeverisë me organizatat antigjinore dhe shfrytëzimi i tyre i sulmeve ndaj hapësirave kulturore, sidomos në periudhën parazgjedhore si opozitë e atëhershme, ka radikalizuar më tej opinionin dhe ka forcuar pikëpamjet e tij konservatore. Si pasojë e gjithë kësaj, në ditën e mbylljes së projektit "Sheqeri i hidhur", nga frika e reagimeve, muzeu vendosi sigurim para dhomës ku projektoheshin videot, të cilat u censuruan dhe u fikën. Rezultati zbuloi erozionin e thellë të lirisë artistike dhe integritetit kuratorial, dhe rezultoi në mbikëqyrje dhe kontroll mbi projektin - si mekanizma për të qetësuar reagimin publik. Në vend që të mbrohen hapësirat kulturore, ato u bënë viktima të agjendave politike, duke minuar integritetin e artit dhe dialogun kritik.

Pavarësisht stresit dhe zemërimit që i shkaktoi rasti, Jovanoviq sjell me vete një perspektivë që ka sjellë shpresë dhe inkurajim për sfidat e ardhshme. Ai e vendos këtë ngjarje në një kontekst më të gjerë dhe tregon se ka përjetuar shkurtimisht problemet e përditshme me të cilat përballen personat LGBTQI+. Reflektimi i tij nxjerr në pah lidhjen midis shtypjeve historike dhe narrativave bashkëkohore antigjinore, duke bërë thirrje për ndjeshmëri dhe rezistencë. Ky vëzhgim qëndron si një kujtesë se, pavarësisht presioneve, arti dhe diskursi kritik kanë fuqinë për të sfiduar hegjemoninë dhe për të nxitur ndryshimet shoqërore.

> "Nuk është hera e parë që gjendem në një situatë të tillë, pasi provokimi ka qenë një komponent integral në shumë prej veprave të mia. Por kjo është hera e parë që kam krijuar përmbajtje me një temë eksplicite homoseksuale. Dhe, pavarësisht se kam miq dhe artistë homoseksualë dhe ata kanë mbështetjen time, për herë të parë kuptova plotësisht traumat nëpër të cilat kalon komuniteti LGBTQI+. Për herë të parë, e ndjeva plotësisht se si është të jesh në këpucët e tyre. Kam qenë i vetëdijshëm edhe më parë për dramat që ata kalojnë. Kam vite që mbështes komunitetin. Pyetja është nëse atyre u pengonin skenat eksplicite, apo tema në vetvete, apo jo", thotë Jovanoviq.

Pas rastit të gjuhës së urrejtjes, punonjësit e muzeut u vërejt një frikë dhe ngurrim të dukshëm ndaj ekspozimit të veprave të artit me tema më eksplicite. Disa artistë, në mënyrë anonime, treguan se kanë ndier ndryshime në qasjen dhe komunikimin nga punonjësit e institucioneve publike të kulturës, si reflektim i drejtpërdrejtë i gjuhës së urrejtjes publike dhe censurës në komunikimin digjital.

Artistë të tjerë, duke menduar për trajtimin e mundshëm që do të përjetonin nëse do të ekspozonin vepra queer, qoftë në hapësira institucionale apo të pavarura, shprehën një ambivalencë midis dëshirës për rezistencë dhe hapje dhe frikës nga urrejtja, dhuna dhe keqinterpretimi i punës së tyre. Ndërsa, disa thonë se është e mundur të censurojnë veten pas këtyre ngjarjeve dhe të tërhiqen në hapësira më të hapura dhe të pavarura, kurse të tjerë i shohin përvojat si motivim për të vazhduar, pavarësisht zhgënjimeve dhe sfidave. Gjuha e urrejtjes, në këtë kuptim, shkakton edhe përhapjen e efektit të stigmatizimit, i cili minon lirinë e shprehjes dhe ripërcakton hapësirën kulturore publike si subjekt i kontrollit dhe heshtjes së vetë-imponuar.

> "Nga njëra anë, ndjehem solidar, i vendosur dhe më i sigurt se kurrë që nuk dua të censuroj veten dhe të tërhiqem. Përkundrazi, dua të jem edhe më i zëshëm dhe më i hapur. Nga ana tjetër, kam frikë nga urrejtja, dhuna dhe neveria me të cilat ndonjëherë reagon publiku, veçanërisht sepse i kam ndjerë në rrethe shumë më të vogla dhe më të afërta. Dua të them se këtë e përballoj lehtë dhe me guxim, por e vërteta është se vazhdoj ta censuroj dhe zbut veten, edhe pse që moti kjo më është bërë e padurueshme.» (X.X.)

> "Ndjekja e ngjarjeve rreth ekspozitës *Sheqeri i hidhur* ishte një përvojë jashtëzakonisht e frikshme, jo vetëm për shkak të përmbajtjes së mesazheve dhe deklaratave, por edhe për shkak të shpejtësisë me të cilën ato u përhapën nëpër mediat sociale. Kjo situatë vetëm se konfirmoi dyshimin tim se në të ardhmen, veprat e artit queer dhe veprat e artistëve queer do të interpretohen, ekspozohen dhe shpjegohen me terma që shmangin synimet e artistëve dhe kuptimet e veprave. Si artist, për shkak të kësaj situate do të isha i rezervuar edhe në mënyrën se si propozoj veprat, tekstet me të cilat aplikoj për ekspozita apo financime projektesh, deklaratat publike që bëj për veprat, sidomos kur ekspozoj në institucionet kombëtare. Hapësirat që unë i konsideroj më të hapura dhe të lira për artin queer dhe artistët queer në vendin tonë janë hapësirat e artit joinstitucional dhe të pavarur". (Y.Y.)

> "Është problematike që muzeu si hapësirë të bëhet një tjetër *fushëbeteje* me të cilën duhet të përballesh. Mendimi kryesor në muze nuk është *se sa qëndroni besnik ndaj vetes, por çfarë do të donin të bënin prej teje*, në çfarë konteksti do të donin t'ju vendosnin. Jam përjashtuar dhe tallur në shumë mënyra për ekzistencën dhe krijimin tim queer, duke filluar nga një galeri, e më pas edhe kam qenë i kritikuar publikisht në rrjetet sociale për artin tim. Në asnjë moment nuk më demotivoi, mund të them që më frustroi për momentin, në procese. Por nuk më ka demotivuar kurrë." (Z.Z.)

Censura në institucionet kulturore, e nxitur nga ndikimet antigjinore, është një fenomen i heshtur, por i rrënjosur thellë, që rrallëherë bëhet objekt i debatit publik. Prandaj, muzetë duhet të marrin një rol proaktiv në mbështetjen e temave provokuese

dhe kritike, duke qëndruar pas artistëve si ekip që do të refuzojë praktikat e censurës. Kompromiset jo vetëm që shtrembërojnë veprat e artit dhe qëllimin e tyre origjinal, por edhe dërgojnë mesazhin se censura është një mekanizëm legjitim që duhet duruar për të qenë i dukshëm në hapësirën publike. Në këtë kontekst, solidariteti dhe mbështetja nga komuniteti kulturor dhe institucionet janë thelbësore për inkurajimin e artistëve për të krijuar art kritik dhe transformues.

3.3. Shprehja gjinore dhe seksualiteti i artistëve – objekt i gjuhës së urrejtjes në media

Rastet e gjuhës së urrejtjes që synojnë artistët e rinj, gjinia dhe/ose shprehja seksuale e perceptuar e të cilëve po diskutohej në publik, zbuluan jotolerancën e rrënjosur thellë shoqërore dhe paraqesin barriera të mëdha për lirinë e shprehjes. Një nga këto raste lidhet me video intervistën e artistit Hristijan Nashullovski për Sllloboden Peçat, e cila u prit me komente të shumta fyese dhe kërcënuese në rrjetet sociale. Komentet, që synonin pamjen e tij, identitetin gjinor dhe shprehjen artistike, përmbanin mesazhe homofobike dhe çnjerëzore si *"Peder ik në Greqi"* dhe *"Ec varu"*, të cilat shënjestruan jo vetëm artistin, por edhe komunitetin më të gjerë LGBTQI+. Përkundër përkrahjes së miqve dhe reagimeve pozitive, Nashullovski nuk e ka raportuar rastin tek organet kompetente, ndërsa komentet nën postim janë ende aktive, edhe pse vetë ai e ka treguar problemin te kjo media.

Këto komente pasqyrojnë jo vetëm urrejtje personale, por edhe paragjykime sistematike që përforcohen përmes hapësirës digjitale. Komentet radikale, si *"Hitler, kthehu për hir të Zotit, gjithçka të është falur"*, inkurajojnë më tej ideologjitë e rrezikshme dhe normalizojnë dhunën kundër grupeve të margjinalizuara. Përmbajtja e tyre jo vetëm që kërcënon sigurinë personale të artistëve, por gjithashtu dekurajon artistët të krijojnë vepra që vënë në dyshim normat dhe vlerat shoqërore. Ngjarje të tilla krijojnë një atmosferë toksike publike, ku diskursi agresiv bëhet një mjet për të heshtur zërat krijues dhe për t'i dëbuar ata nga shteti.

Një rast i ngjashëm është vërejtur edhe me intervistën e artistit Krsto Anastas Gligorijadis, e cila trajtonte çështje të mashkulloritetit dhe identitetit gjinor. Megjithëse komentet e gjuhës së urrejtjes nën postim u hoqën menjëherë, reagimet negative vazhduan të përhapeshin, duke reflektuar të njëjtën intolerancë dhe rezistencë ndaj diversitetit.

Këto raste treguan qartë se arti që sfidon rendin tradicional është shpesh objekt i gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve, të cilat jo vetëm që rrezikojnë artistët, por edhe minojnë zhvillimin kulturor dhe krijues të komunitetit. Gjuha e urrejtjes nuk është vetëm një shprehje individuale, por edhe një problem strukturor që rrënon hapësirën publike dhe zvogëlon dukshmërinë e identiteteve të margjinalizuara. Kjo tregon një nevojë urgjente për përpjekje institucionale dhe shoqërore për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe për të promovuar tolerancën. Institucionet, media dhe shoqëria civile duhet të marrin masa aktive për të krijuar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës, në të cilin artistët mund të krijojnë pa frikë nga dhuna dhe diskriminimi, pavarësisht nga seksualiteti dhe identiteti i tyre gjinor.

Vështrime përmbyllëse

Stabiliteti demokratik i Maqedonisë së Veriut është i lidhur pazgjidhshmërisht me mbrojtjen e hapësirës qytetare, të punëtorëve dhe artistëve të kulturës, si dhe me avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut. Rritja e mobilizimeve antigjinore dhe diskursi i tyre me ndikim përbën një kërcënim të thellë jo vetëm për komunitetet e margjinalizuara, por edhe për vetë themelet e vlerave demokratike dhe sundimit të së drejtës. Këto lëvizje nuk janë vetëm një shprehje e thjeshtë e pikëpamjeve konservatore, por një forcë regresive që minon hapësirën publike dhe angazhimet institucionale ndaj gjithëpërfshirjes.

Mbrojtja e palëve të prekura që janë sulmuar nga retorika antigjinore gjatë vitit të kaluar është diçka më tepër se sa mbrojtje e të drejtave të njeriut; është thelbësore për ruajtjen e qëndrueshmërisë demokratike përballë forcave autoritare dhe diskriminuese në rritje. Adoptimi i një qasjeje ndërsektoriale, e cila njeh format e ndërthurura të shtypjes, dhe një qasje e bazuar në të drejtat është e nevojshme për të kundërshtuar narrativën regresive dhe për të riafirmuar angazhimin e vendit për një demokraci gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.

Në kushtet e ngushtimit të hapësirës qytetare dhe forcimit të lëvizjeve antigjinore, përgjigja kritike duhet të jetë e shumëanshme dhe e ndërthurur. Një qasje e tillë duhet t'i japë përparësi dukshmërisë dhe mbrojtjes së zërave të margjinalizuar, veçanërisht artistëve dhe interpretuesve queer, kontributet krijuese të të cilëve shpesh heshten përmes censurës dhe bojkotit. Këta zëra jo vetëm që pasurojnë diskursin kulturor dhe social, por përfaqësojnë edhe një pikë thelbësore rezistence ndaj strukturave hegjemoniste që minojnë kohezionin social.

Në këtë kontekst nevojitet veprim sistematik dhe kolektiv. Kjo përfshin angazhime institucionale, ndërtimin e një qëndrimi kolektiv të bazuar në ide dhe vlera progresive, si dhe krijimin dhe zbatimin aktiv të strategjive për mbrojtje kundër censurës, bojkotit dhe margjinalizimit. Nëpërmjet këtyre angazhimeve, mund të sigurohet që hapësira publike të mbetet një vend për dialog gjithëpërfshirës dhe demokraci, rezistente ndaj kërcënimeve të diskriminimit dhe shtypjes.

Rekomandime

- Mekanizmat vendas të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht policia, prokuroria dhe gjyqësori, duhet të ofrojnë mbrojtje ligjore dhe institucionale që mbron pa mëdyshje lirinë e organizimit, tubimit dhe shprehjes, veçanërisht për grupet e margjinalizuara si gratë dhe aktivistët LGBTQI+. Nevojiten mekanizma të qarta për trajtimin e dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve, duke përfshirë përgjegjësinë për autorët, për të ruajtur hapësirën qytetare.

- Politikat kombëtare duhet të integrojnë perspektivat gjinore dhe të adresojnë prekshmërinë ndërsektoriale të komuniteteve të margjinalizuara. Reformat në lidhje me anëtarësimin në BE duhet të theksojnë përfshirjen e grave dhe personave LGBTQI+ përmes proceseve pjesëmarrëse që nxisin gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë demokratike.

- Kundërshtimi i narrativave antigjinore kërkon komunikim strategjik që promovon mesazhe të sakta për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Institucionet publike dhe shoqëria civile duhet të krijojnë narrativa që adresojnë sfidat lokale socio-ekonomike dhe kulturore, veçanërisht duke mbështetur artistët dhe interpretuesit queer si zëra të rëndësishëm në luftën për përfshirje dhe dialog.

- Partnerët ndërkombëtarë, përfshirë BE-në, duhet të mbështesin aktivisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe hapësirës civile në Maqedoninë e Veriut duke monitoruar veprimet e qeverisë dhe duke mbështetur artin dhe pluralizmin kulturor. Solidariteti dhe llogaridhënia në nivel ndërkombëtar janë kyçe për nxitjen e rolit transformues të arteve queer dhe mbrojtjen e të drejtave kulturore dhe të njeriut.

(Autoret janë hulumtuese në Koalicionin MARGJINAT)

BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT

Raporte, hulumtime dhe zgjidhje

Drndarevska, D., & Veliçkovska, M. (2025). *Hulumtimi mbi dhunën institucionale kundër personave LGBTQI+ në Maqedoninë e Veriut (2021 - 2023)*. Koalicioni MARGJINAT. (Së shpejti).

Raport tremujor për situatën me gjuhën e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut. (2024, janar - mars). Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Në dispozicion në https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2024/04/5-kvartalen-izveshtaj-govor-na-omraza.pdf

Prokuroria Themelore Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2024). Vendimi, HSh KO nr. 1510/24. Shkup, 23 prill.

Cvetkoviq, I., & Veliçkovska, M. (2021). *Kush ka frikë nga gjinia? Analiza e strategjive kryesore dhe narrativave të lëvizjeve antigjinore në Maqedoninë e Veriut.* Koalicioni MARGJINAT.

Në dispozicion në https://coalition.org.mk/archives/portfolio_page/koj_se_plashi_od_rodot

Bibliografia e botimeve në internet

Angell Dimitrievski. (2024). *E ngecur në qeliza.* Meduza. Në dispozicion në https://meduza.mk/my-body/zaglaveni-vo-kletkite/

VIDEO INTERVISTË | Gligoriadis. (2024, Nëntor). *A më vjen turp që jam mashkull në këtë qytet?* Sllloboden Peçat. Në dispozicion në https://www.slobodenpecat.mk/videointervju-gligorijadis-dali-se-sramam-da-bidam-mazh-vo-ovoj-grad/

VIDEO INTERVISTË | Nashullovski. (2024, qershor). *Moda është mënyra ime e të shprehurit, kam thurur dhe qëndisur falë gjyshes sime.* Sllloboden Peçat. Në dispozicion në https://www.slobodenpecat.mk/videointervju-nashulovski-moda-ta-e-moj-nachin-na-izrazuvanje-pletev-i-vezev-blagodarenie-na-baba-mi/

Ekipi i lajmeve (2024, 19 shkurt). *Fëmijëve nuk u shfaqën përmbajtje pornografike në Muzeun e Artit Bashkëkohor - Shkup.* Vërtetmatës. Në dispozicion në https://meta.mk/na-deca-ne-im-bila-prikazhuvana-pornografska-sodrzhina-vo-muzejot-na-sovremena-umetnost-skopje/

Equalis. (2024, 15 korrik). *LETËR E HAPUR PËR PUBLIKUN Urrejtja, kërcënimet me jetë dhe thirrjet për linçim për Shkollën Verore Equalis për rininë LGBTQI+ dhe aleatët.* Në dispozicion në https://ekvalis.org.mk/отворено-писмо-до-јавноста-омраза-смр/

Petar Klinçarski. (2024, 17 gusht). *Jehona e urrejtjes - kur fjalimi në internet nxit dhunë ndaj personave LGBTQI+.* Radio Evropa e Lirë. Në dispozicion në https://www.slobodnaevropa.mk/a/lgbti-omraza-presuda-/33067748.html

Bibliografia e fragmenteve nga postimet e lartpërmendura në Facebook

Lupço Ristevski. (2024, 15 qershor). *Njoftim kundër shkollës verore "Equalis".* Facebook.

Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve. (2024, prill). *Njoftimi i bojkotit të aktivitetit "Rruga e tranzicionit" organizuar nga ShSMM.* Facebook.

Shoqata e Studentëve të Mjekësisë Maqedonase - ShSMM. (2024, prill). *Deklaratë për anulimin e aktivitetit "Rruga e tranzicionit"*. Facebook.

Nedan Panovski. (2023, dhjetor*). Njoftim për ekspozitën "Sheqeri i hidhur" në Muzeun e Artit Bashkëkohor.* Facebook.

Merr përgjegjësi. (2024, 10 dhjetor). *Shpallje për ndarjen e çmimit "Meto Jovanovski" për Lilla Miliq.* Facebook.

Merr përgjegjësi. (2024, 16 shkurt). *Njoftim për projektin "Sheqeri i hidhur" nga Gjorgje Jovanoviq.* Facebook.

Fronti prindëror. (2024, 6 dhjetor). *Komentet për ndarjen e çmimit "Meto Jovanovski".* Facebook.

Tomisllav Karanfillovski. (2023, 14 qershor). *Njoftim për kërcënime për shkak të një prezantimi me temën "Libraritë dhe popullata LGBTQI+"*. Facebook.

Referencat në analizë:

1 Drndarevska, D., & Veliçkovska, M. (2025). *Hulumtimi mbi dhunën institucionale kundër personave LGBTQI+ në Maqedoninë e Veriut (2021 - 2023).* Koalicioni MARGJINAT. (Së shpejti).

2 Aktorët antigjinorë, në përpjekjet e tyre për të arritur qëllimet e tyre parësore, u mobilizuan në forma të ndryshme shoqërimi në vitin 2021. Nismat e tyre fillimisht mund të shiheshin përmes veprimeve të katër grupeve: "Merr përgjegjësi", "Nga ne tek ne", "Tekste dhe mësimdhënie duhet ketë patjetër" dhe "Ta ruajmë martesën dhe familjen". Në vitin 2021, këto grupe u bashkuan në Koalicionin për Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili tani bashkon mbi 38 subjekte, duke përfshirë organizata humanitare, shoqata fetare, iniciativa joformale dhe tre parti politike të ekstremit të djathtë (Rodina, Integra dhe MAAK). Shih më shumë në Cvetkoviq, I., & Veliçkovska, M. (2021). *Kush ka frikë nga gjinia? Analiza e strategjive kryesore dhe narrativave të lëvizjeve anti-gjinore në Maqedoninë e Veriut*. Koalicioni MARGJINAT, dhe në Milenkovska, S. (2022*) Si lëvizjet antigjinore* bëjnë prapakthim të barazisë gjinore dhe luftës *kundër dhunës me bazë gjinore*

3 Prokuroria Themelore Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2024). Vendimi, HSh KO nr. 1510/24. Shkup, 23 prill.

4 Kolona e pestë - grup i organizuar njerëzish që veprojnë brenda një vendi, lëvizjeje ose partie në favor të armikut.

5 Ekipi i lajmeve. (2024, 19 shkurt). *Fëmijëve nuk u shfaqën përmbajtje pornografike në Muzeun e Artit Bashkëkohor - Shkup.* Vërtetmatësi.

